



**Komuna e  
Obiliqit  
2012/2017**

*...për qytetin tim!*

# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis





# Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

2012/2017



Komuna e Obiliqit

Projekti është financuar nga:



Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Zbatimi i projektit është mbështetur edhe nga:



MMPH dhe MAPL.

Ky projekt është zbatuar nga:



**REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER**

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.

---

Botim i Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë.  
<http://kosovo.rec.org/>; <http://www.rec.org/>

PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS 2012/2017

Copyright © 2012 REC

Të drejtat e botimit të këtij publikimi i mban:

Qendra Rajonale e Mjedisit, REC – Zyra në Kosovë

Design & Layout: Arben Grajqevci (Rrjeti)

Shtypi: RRJETI, Prishtinë



# Përmbajtja

Ç'është REC? .....	8
Fjala e Kryetarit të Komunës.....	9
Fjalorthi i shkurtesave.....	10
Akterët dhe përgjegjësitë e PLVM-së.....	11

## Pjesa 1

I. HYRJE.....	15
Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së .....	15
Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të: .....	15
Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së .....	16
Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:.....	17

## Pjesa 2

I. PROFILI I KOMUNËS .....	19
1. Historiku.....	19
2. Pozita dhe veçoritë gjeografike .....	19
2.1. Kushtet klimatike .....	20
3. Struktura Demografike e Komunës .....	20
3.1 Popullsia .....	20
3.2 Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë .....	21
3.3 Migrimet e popullsisë .....	22
3.4. Vendbanimet dhe tipi i vendbanimit .....	22

## Pjesa 3

II. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE.....	23
1. ZHVILLIMI SOCIAL.....	23
1.1 Arsimi .....	23
1.1.1 Edukimi mjedisor .....	25
1.2. Shëndetësia .....	25
1.2.1. Rreziqet shëndetësore dhe mjedisi.....	26
1.2.2. Efektet shëndetësore nga ndotja e mjedisit.....	27

1.3. Kultura dhe Sporti .....	27
1.3.1. Trashëgimia arkeologjike dhe kulturo-historike .....	27
1.3.2. Fushat sportive ekzistuese-publike .....	29
2. ZHVILLIMI EKONOMIK .....	30
2.1 Sektori Energjetik .....	30
2.1.1 Eksploatimi i linjitit .....	30
2.1.2 Termocentralet .....	31
2.2 Tregtia .....	31
2.3 Bujqësia .....	31
2.3.1 Blegtoria .....	32
2.4 Pylltaria .....	32
2.4.1 Shkatërrimi i pyjeve dhe kullotave .....	32
2.5 Turizmi .....	33
3. MJEDISI .....	33
Situata aktuale në mjedis .....	33
3.1. Ajri 33	
3.1.2. Vlerësimi i shkaqeve dhe problemet (kërcënimet) në cilësinë e ajrit .....	34
3.1.3. Kontrolli-Monitorimi i kualitetit të ajrit .....	34
3.1.4 Problemet me prioritet.....	35
3.2 Uji .....	35
3.2.1. Burimet kryesore të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore .....	36
3.3 Toka 37	
3.3.1 Toka dhe përdorimi i tokës .....	37
3.3.2 Ndotja dhe degradimi i dheut .....	37
3.4 Zhurma-Presioni.....	39
3.4.1 Komentet mbi të dhënat ekzistuese dhe sugjerimet .....	39
3.5 Peizazhi .....	39
3.5.1 Biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore .....	40
3.5.2. Flora dhe Fauna .....	41
4. Planifikimi i hapësirës në territorin e Komunës.....	42
4.1 Planifikimi urban .....	42
4.2 Gjelbërimi publik .....	42
5. Infrastruktura .....	43
5.1 Rrjeti rrugor.....	43
5.2 Hekurudhat.....	44
6. Shërbimet publike .....	45
6.1 Furnizimi me ujë cilësorë të pijes .....	45
6.2. Menaxhimi i ujërave të zeza-sanitare .....	46
6.2.1 Rrjeti ekzistues i kanalizimit të ujërave të zeza-sanitare.....	46
6.3 Menaxhimi i shërbimit me mbeturina të ngurta komunale (MNK) .....	47
6.3.1 Organizimi i shërbimit për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave .....	47
6.3.2 Riciklimi i mbeturinave .....	48
6.3.3 Ndikimet negative të mbeturinave në mjedis .....	48
6.3.4 Deponija rajonale e Prishtinës në Mirash .....	49
6.3.5 Problemet e evidentuar në menaxhimin e mbeturinave .....	49

7. Hulmtimi i opinionit publik në Komunën e Obiliqit për gjendjen mjedisore dhe problemet mjedisore me prioritet.....	51
7.1 Metodologjia e hulmtimit .....	51
7.2 Rezultatet e anketës .....	51

## Pjesa 4

III. Identifikimi i problemeve mjedisore me prioritet .....	55
---	----

## Pjesa 5

IV. VLERËSIMI I PROBLEMEVE PRIORITARE .....	57
---	----

## Pjesa 6

V. VIZIONI, MUNDËSITË DHE SYNIMET .....	65
---	----



## Ç'është REC?

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) është organizatë ndërkombëtare neutrale, joavokuese dhe jofitimprurëse, e cila mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL). Kjo qendër e përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), qeverive, bizneseve si dhe personave tjerë kyç mjedisor si dhe duke përkrahur këmbimin e lirë të informatave dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen për mjedis. REC është themeluar në vitin 1990 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Aktualisht, REC bazohet ligjërisht në Kartën e vet, nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve dhe Komisioni Evropian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është në Szentendre, Hungari si dhe zyrat fushore dhe zyrat e shteteve në 17 vendet përfituese.



## Fjala e Kryetarit të Komunës

**P**ërgatitja e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) u realizua nga bashkëpunimi i ngushtë i përfaqësuesve të pushtetit vendor, organizatave jofitimprurëse dhe qytetarëve të Komunës së Obiliqit, duke diskutuar dhe paraqitur zgjidhje konkrete të problemeve mjedisore në nivel vendor.

Ky proces ka ndihmuar zhvillimin e shoqërisë civile në nivel vendor, përmes përgatitjes me metodën e pjesëmarrjes të një plani veprimi, për të adresuar prioritetet më të rëndësishme dhe zbatimin e strategjive më efektive në këndvështrimin social, financiar dhe kohor.

Sugjerime dhe projekte konkrete për zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe përfshirjen aktive të publikut e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë, do të bëjnë të mundur që procesi i zbatimit të tij dhe tërheqjes së donatorëve për financime në Komunën e Obiliqit të jetë i sigurt.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është një dokument pune, i cili pritet të shërbejë si hap i parë i thithjes së investimeve për përmirësimin e mjedisit në Komunë, për 5 vjetet e ardhshme. Ky dokument do t'ju shërbejë të gjithë akterëve vendorë dhe qendrorë për fokusimin e investimeve të tyre në fushën e mjedisit.

*Singerisht:*  
*Mehmet KRASNIQI*  
*Kryetar i Komunës së OBILIQIT*

## Fjalorthi i shkurtesave

KK	- Kuvendi Komunal
KEK	- Korporata Elektro-Energjetike e Kosovës
AKMM	- Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	- Agjencioni Pyjor i Kosovës
ASK	- Agjencioni i Statistikave të Kosovës
BE	- Bashkimi Evropian
IKSHPK	- Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
ISHP	- Instituti i Shëndetit Publik
MAPL	- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MMPH	- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MShP	- Ministria e Shërbimeve Publike
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	- Organizata Joqeveritare
PKVM	- Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVM	- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PM10, PM2.5	- Grimcat e suspenduara në ajër
PZHK	- Plani Zhvillimor Komunal
PZHU	- Plani Zhvillimor Urban
VNM	- Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	- Vlerësimi Strategjik Mjedisor
QKMF	- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
REC	- Qendra Rajonale e Mjedisit
Sida	- Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtarë

## Akterët dhe përgjegjësit e PLVM-së

Ky Projekt është implementuar nga:

**Qendra Rajonale e Mjedisit, REC** (Regional Environmental Center) - Zyra në Kosovë.

Koordinatori i REC për PLVM:

BSc. Faton KAQKINI

### **Komuna e Obiliqit**

Koordinatori i Komunës për PLVM:

Nazif SHALA

### **Anëtarët e Trupit Koordinues:**

1. Mehmet Kasniqi, Kryetar i Komunës, udhëheqës i TK;
2. Agim Preniqi, përfaqësues nga subjekti politik PDK;
3. Afërdita Strellce, përfaqësues nga subjekti politik LDK;
4. Burim Gërguri, përfaqësues nga subjekti politik AAK;
5. Ajet Berisha, përfaqësues nga subjekti politik LB;
6. Ramiz Selmani, përfaqësues nga subjekti politik AKR-PD dhe;
7. Nazif Shala, Koordinator i PLVM.

**Anëtarët e Grupit Punues:**


1. Nazif Shala, Drejtorja e Mbrojtjes së mjedisit (DMM);
2. Hajrulla Sallova, Nënkrjetar i Komunës;
3. Lulzim Mjekiqi, Drejtorja e Mbrojtjes së Mjedisit (DMM);
4. Azem Spanca, Drejtorja për Planifikim Urban, Kadaster dhe Pronë (DPUKP);
5. Imer Berisha, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencia (DSHPE);
6. Valon Prestreshi, Drejtorja për Ekonomi dhe Financa (DEF);
7. Rifadije Paloja, Drejtorja për Kulturë dhe Sport (DKRS);
8. Ismail Hashani, Drejtorja për Kulturë dhe Sport (DKRS);
9. Agim Morina, KEK - Departamenti për Mjedis;
10. Fatime Beka-Pllana, Drejtorja për Arsim dhe Shkencë (DASH);
11. Atifete Shylemaja, Qendra Klinike e Mjekësisë Familjare (QKMF) - Obiliq;
12. Mehmet Ismaili, Zyrtar për Informim K.K. Obiliq;
13. Ganimete Aliu, Zyrtare për Barazi Gjinore;
14. Lavdim Uka, Zyrtar për Teknologji Informativ (IT);
15. Fazli Përvetica, Drejtorja e Mbrojtjes së mjedisit (DMM);
16. Dragisha Jovic, Drejtorja e Mbrojtjes së mjedisit (DMM);
17. Kushtrim Mirena, Zyrtar për Integritim Evropian (IE);
18. Bashkim Mehani, Këshilli i Bashkësisë Islame, Obiliq;
19. Musli Mjeku, OJQ Grupi Lokal i Veprimit “Procesi” Obiliq dhe;
20. Valmir Sadiku, OJQ Këshilli i Veprimit Lokal – Obiliq.

**Gjithashtu, në hartimin e dokumentit ndihmuan:**

- NDËRMARRJET PUBLIKE DHE KOMUNITETI I BIZNESIT PRIVAT;
- NDËRMARRJET PUBLIKE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE;
- KOMPANITË RAJONALE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE DHE;
- SHOQËRIA CIVILE DHE QYTETARËT.



## Baza ligjore për hartimin e PLVM-së



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo- Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në bazë të nenit 12.2 pika d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në bazë të nenit 24 pika 1 dhe 2 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25, dhe të nenit 31 dhe 35, të statutit të Komunës dhe nenit 11 dhe 3.9 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kuvendi komunal në mbledhjen e vet të mbajtur me 27/09-2011 mori këtë:

### VENDIM

Për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 2011-2016

Neni 1.

Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm komunal në Komunën e Obiliqit bëhet hartimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis.

Neni 2.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis duhet të përmbajë të gjitha elementet themelore të cilat janë përcaktuar në nenin 24 të Ligjit për mbrojtje të mjedisit Nr.03/L-25, dhe elemente të Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010.

Neni 3.

Ngarkohet Kryetari i komunës dhe drejtori i DMM për themelimin e grupit punuese për hartimin e PLVM.

Neni 4.

Obligohen të gjitha drejtorit në kuadër të komunës që të ofrojnë informatat e duhura tematike dhe të bashkëpunojnë në hartimin e PLVM.

Neni 5.

Projekti prioritar, që do të dalë nga dokumenti i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, do të bashkëfinancohet nga Komuna e Obiliqit me participim me mjete financiare në vlerë prej 20.000€ (njëzet mijë euro) dhe shteti Suedisë përmesë SIDA si mbështetës financiar i REC-ut me 40.000€ (katërdhjet mijë euro).

Neni 6.

Ky vendim hyn në fuqi me ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal i Obiliqit

Dt:27/09-2011  
Obiliq

Kryesuesi i Kuvendit Komuna të Obiliqit  
Hariz Bektashi

**Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes te mjedisit harmonizuar me standardet evropiane që është përdorur si referencë për përgatitjen e PLVM-së.**

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2009/03-L-025)
- Ligji për Mbeturinat (2005/02-L30)
- Ligji për Mbrojtjen e ajrit (2004/30)
- Ligji për Mbrojtjen e bimëve (2006/02-L95)
- Ligji për Mbrojtjen e natyrës (2005/02-L18)
- Ligji për Mbrojtjen e varieteteve të bimëve (2007/02-L98)
- Ligji për Mbrojtjen nga zhurma (2007/02-L102)
- Ligji për Mbrojtjen nga zjarri (2006/02-L41)
- Ligji për Bujqësi dhe zhvillim rural (2009/03-L-98)
- Ligji për Bujqësi organike (2007/02-L122)
- Ligji për Gjuetinë (2005/02-L53)
- Ligji për Plehrat Artificiale (2003/10)
- Ligji për Planifikim Hapësinorë (2003/14)
- Ligji për Pyjet ndryshim (2004/29)
- Ligji për Ujërat (2004/24)
- Ligji për Ujitjen e tokave bujqësore (2005/02-L9)
- Ligji për Vlerësimin e ndikimit në mjedis (2009/03-L-024)
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale (2008/03-L040)
- Ligji për Zonat e veçanta të mbrojtura (2008/03-L039)
- Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (2009/03-L-015)
- Udhëzimi administrativ Nr 02/07 për mbeturina nga Bateritë dhe Akumulatorët
- Udhëzimi administrativ Nr 03/07 për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë
- Udhëzimi administrativ për automjete e hedhura dhe mbeturinat e tyre, 20.12. 2006
- Udhëzimi administrativ Nr. 12/2008 për asgjësimin e mbeturinave medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2008 për administrimin me mbeturinat medicinale
- Udhëzimi administrativ Nr. 05/2009 për administrimin e mbeturinave publike
- Udhëzimi administrativ Nr. 04/2009 për ndëshkime dhe gjoba mandatore
- Planin Kombëtarë për Veprim në Mjedis i Kosovës, 2006-2010

# Pjesa 1

## I. HYRJE

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente të politikës mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit vendor dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

Gjithashtu, PLVM nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

### Detyrimet ligjore për hartimin e PLVM-së

Përgatitja e PLVM-së është e detyrueshme për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që kanë filluar procesin e asocim-stabilizimit dhe që synojnë të integrohen në BE. Për vendin tonë, hartimi i këtyre planeve nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore, e përcaktuar në Nenin 24 të **Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr.03/L-25**

### Plani lokal për Veprim në Mjedis ka për qëllim të:

- Zgjidh problemet mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Zhvillojnë shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, duke sjellë së bashku përfaqësues të komuniteteve të ndryshme që përfaqësojnë interesa të ndryshme në këto komunitete, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin, shkencëtarë, duke shpjeguar teknikat specifike që organizatorët lokalë mund të përdorin për të përcaktuar aktorët kryesorë të procesit, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces, për rekrutimin dhe punën me vullnetarët dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.
- Rrisin aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plan Veprimi.

- Rrisin shkëmbimin e informacionit në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.
- Japin zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

### Metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Obiliqit u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij, janë përfshirë akterë të pushtetit vendorë dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me specialistë të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë tjerë vendor dhe ndërkombëtarë për hartimin e PLVM.

Së pari, është bërë trajnimi i grupit punues të cilët u ftuan në projekt në aspektet e hartimit të PLVM-së dhe gjetjes së mjeteve shtesë për realizimin e aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë mjedisore.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Obiliqit. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin punues në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Obiliqit dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm. Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Dokumenti i është paraqitur Kuvendit Komunal të Obiliqit dhe është miratuar prej tij më 30.05.2012, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune.

#### **Procesi themelor i hartimit të PLVM-së ndahet në faza, të cilat lidhen njëra pas tjetrës:**

- a) Nënshkrimi i marrëveshjeve dhe memorandumeve REC – Komunë;
- b) Aktivitetet përgatitore;
- c) Formimi i trupit koordinues TK;
- d) Formimi i grupit punues GP;
- e) Trajnimi i GP
- f) Vlerësimi i gjendjes së mjedisit;
- g) Anketimi i qytetarëve;
- h) Hartimi i vizionit të komunitetit;
- i) Caktimi i prioriteteve;
- j) Hartimi i planit të veprimit për fushat prioritare dhe;
- k) Caktimi i prioriteteve në realizimin e planit të veprimit.

Dokumenti është i hartuar mbi tri baza kryesore:

**1. Analiza e gjendjes mjedisore**

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Obiliqit.

**2. Lista e problemeve mjedisore**

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

**3. Plani i veprimeve për zgjidhje**

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.

Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

# VIZIONI

*“Komuna e Obiliqit, qendër industriale për prodhimin e energjisë së pastër nga Linjiti, me një Mjedis të planifikuar dhe të menaxhuar sipas kërkesave dhe standardeve të BE-së, që siguron rritje ekonomike, mirëqenie sociale dhe gjendje të kënaqshme mjedisore”.*

## Pjesa 2

### I. PROFILI I KOMUNËS

#### 1. Historiku

Obiliqi ka funksionuar si Komunë (nahi) qysh gjatë kohës së sundimit turk. Në vitin 1873 është ndërtuar hekurudha Shkup-Mitrovicë, ndërsa në Obiliq, si qendër gjeostrategjike e rrafshnaltës së Kosovës është ndërtuar stacioni hekurudhor grumbullues. Kështu, vendbanimi i atëhershëm i kuajtur Gllobodër u ngrit në një qendër rajonale Komunë. Në vitin 1912 merr emërtimin e ri, Obiliq.

Statusin e Komunës e kishte, gjithashtu, pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, gjithnjë deri në vitin 1962, kur është përfshirë në kuadër të Komunës së Prishtinës. Më 27 nëntor 1989 prapë konstituohet si Komunë.

#### 2. Pozita dhe veçoritë gjeografike

Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën skajore të rrafshit të pasur të Kosovës, 10 km. në veri-perëndim të Prishtinës, qendër administrative, politike dhe universitare e Republikës së Kosovës. Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: Komunën e Prishtinës, të Fushë-Kosovës, Drenasit, Vushtrrisë dhe Besianës. Po ashtu, ka edhe një lidhje hekurudhore të rëndësishme me Fushë-Kosovën, si nyje hekurudhore dhe Mitrovicën.

Territori i Komunës së Obiliqit ka një sipërfaqe prej 105 km<sup>2</sup> dhe zë një hapësirë rreth 1 % të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit “Sitnica” dhe lumit “Llap”, ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në veri, po ashtu, në kodra e lugina të malit të Kopaonikut (Albanikut).




Figura 1. Pozita Gjeografike e Komunës së Obiliqit në Hartën e Republikës së Kosovës



## 2.1. Kushtet klimatike

Territori i Komunës ju nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Sitnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko-teknologjike, si rrjedhojë e zhvillimeve nga industria energjetike. Proceset e emisionit dhe imisionit në këtë zonë kanë shtrirë ndikimin e tyre në aerosolët dhe elementet e tjera klimatologjike. Për shkak të proceseve kimiko-teknologjike, territori ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që variron nga 95 % - 47 %, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45-56 %.

Temperatura e ajrit është e ndryshueshme, ku vlera mesatare vjetore është 10.2°C, nga që muaji më i ftohtë është Janari me -1.5°C, përderisa muaji më i nxehtë është Gushti me temperaturë mesatare vjetore në 20.5°C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9°C, ku me vlerat ekstreme dhe me elementet tjera krijojnë klimën e regjimit kalimtar në mes të klimës mesatare kontinentale të ashpër malore, kur vjeshta është më e nxehtë se pranvera për 1.5°C.

Në regjimin e reshjeve atmosferike të territorit dhe rrethinës, ndikim parësorë kanë aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku, ndërsa ato të nxehtat nga Jugu nga hapësira Mesdhetare, si dhe ato që depërtojnë gjatë dimrit si masa të ftohta të ajrit që vijnë nga Veriu dhe Verilindja. Sasia e reshjeve ndryshon nga 670 - 810 mm.

Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre mund të konstatohet se qetësisë lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe temperaturës me 32.7 %. Prej erërave më së shpeshti është era frontale nga Veri-Verilindja me 20.3 % nga Veriu me 19.4 % dhe ajo që lajmërohet më pak është era në drejtim të Lindjes me 4 %, dhe nga Jugu me 5 %. Era nga drejtimi Verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin Gusht e më së paku në muajin Prill. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit Mars në shumë vite dhe ka vlerën 3.2 m/s, ndërsa më e vogla në muajin Shtator 1.8 m/sekondë.

## 3. STRUKTURA DEMOGRAFIKE E KOMUNËS

### 3.1 Popullsia

Zhvillimi i popullsisë është një fushë mjaft me rëndësi për planifikime dhe zhvillime të ardhshme. Të gjitha zhvillimet në hapësirë bëhen në interes të vetë popullatës. Prandaj, analiza e zhvillimeve demografike është e domosdoshme për planifikim adekuat të zonës, duke aluduar në kërkesat e popullsisë dhe interesin e zonës për zhvillime të ardhshme. Në bazë të rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë numri i banorëve në Komunë është rreth 26.000 banorë.



Tabela 1. Zonat kadastrale, sipërfaqja, vendbanimet, nr. i popullsisë dhe dendësia

Zonat kadastrale	Sipërfaqja km <sup>2</sup>	Vendbanimet	Nr. i banorëve	Dendësia b/km <sup>2</sup>
Obiliq	12.50	Obiliq	5648	487
		Obiliq i vjetër	1160	
Mazgit	6.38	Mazgiti i ultë	1441	452
		Mazgiti i lartë	1445	
Llazareva	2.10	Llazareva	429	204
Milloseva	7.35	Milloseva	2920	397
Bakshi	2.03	Bakshi	602	296
Raskovë	0.92	Raskovë	640	695
Bajmofc	8.04	Bajmofc	1680	209
Breznicë	14.32	Breznicë	1292	123
		Kozaricë	469	
Plemetin	5.73	Plemetin	2588	452
Hamidi	1.74	Hamidi	147	85
Sibofci	7.51	Sibofci	963	129
Grabocfi i Epërm	8.60	Grabocfi i Epërm	340	39
Shipitullë	2.96	Shipitullë	295	100
Hade	4.91	Hade	534	109
Mirash	2.32			
Lajthishtë	3.69	Lajthishtë	715	194
Palaj	7.11	Palaj	1463	206
Dardhishtë	6.64	Dardhishtë	1580	238
<b>Totali</b>	<b>104.85</b>	<b>20</b>	<b>25629</b>	<b>246</b>

### 3.2 Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë

Ka rëndësi të madhe për zhvillimin demografik, ekonomik dhe social. Nga kjo strukturë rrjedhin kontingjentet kyçe të popullsisë, që kanë ndikim në zhvillimin demografik dhe socio-ekonomik të një popullate.

Komuna ka popullsi kryesisht të re, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Mbi 35 % e popullsisë së përgjithshme në këtë zonë janë me moshë të re, 0 deri 18 vjeç. Ndërsa, grup-moshat 19-35 vjeç e përbën mbi 25 % të popullsisë, grup moshë 36-65 vjeç përfshinë rreth 35 % dhe moshë mbi 66-vjeç e popullsisë përfshinë 4.9 % të popullsisë së përgjithshme. Këto të dhëna më së miri tregojnë se kjo zonë, si edhe e tërë Kosova ka një popullsi të re me rreth 60 % të saj nën moshën 35-vjeçare.

Sa i përket raportit gjinor, ekziston një ndryshim i vogël gjinor në popullsinë e kësaj zone, ku popullsia mashkullore dominon me 51.1 %, në krahasim me popullsinë femërore që ka 48.9 % të popullsisë së përgjithshme.

### 3.3 Migrimet e popullsisë

Sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuara dhe shpeshherë reciprocikisht të lidhur e të kushtëzuar. Mungesa e të dhënave demografike në përgjithësi dhe për migrimet në veçanti, vështirëson punën dhe arritjen deri të rezultatet e sakta mbi migrimet për këtë zonë. Sipas vlerësimeve të ndryshme, mund të thuhet se ka migrime të theksuara kryesisht nga viset me të thella rurale drejt atyre urbane. Mirëpo, nuk duhet harruar se kemi të bëjmë edhe me migrime jashtë vendit, të cilët përbëjnë një numër të madh të popullatës. Shkaqet që i kanë kushtëzuar këto migrime janë të natyrave të ndryshme, duke përfshirë ato ekonomike dhe të punësimit, sociale, demografike, politike etj. Shkaqet ekonomike dhe punësimi janë ndër faktorët kryesor që i kanë kushtëzuar këto migrime, për faktin se në vendin tonë një numër i konsiderueshëm nuk kanë mundur të gjejnë punë dhe si zgjidhje e vetme për të siguruar kushte më të mira të jetesës ishte emigrimi në botën e jashtme.

### 3.4. Vendbanimet dhe tipi i vendbanimit

Në tërë Komunën gravitojnë 20 vendbanime të shtrira në 18 zona Kadastrale që janë: Obiliqi, Obiliq i vjetër, Mazgit i ultë, Mazgit i lartë, Llazarevë, Milloshevë, Bakshi, Raskovë, Bajmofc, Breznicë, Kozaricë, Plemetinë, Hamidi, Sibovc, Grabofci i Epërm, Shipitullë, Hade, Mirash, Lajthishtë, Palaj dhe Dardhishtë.

Rreth 5.648 banorë ndodhen në qytezën e Obiliqit, që ka një rregullim urban, dhe rreth 19.981 banorë jetojnë në zonat rurale. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrave urbane dhe janë kryesisht vise rurale, të cilat janë fshatra tipike bujqësore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë. Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Obiliq kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit, si dhe ato të bizneseve, shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, kjo zonë gjithashtu disponon me një fond banesor mjaftë cilësor.

## Pjesa 3

### II. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

#### 1. ZHVILLIMI SOCIAL

##### 1.1 Arsimi

Sistemi i edukimit-arsimit në Komunën e Obiliqit është i organizuar në tri nivele: arsimimi para-fillor, fillor dhe i mesëm.

Në Komunën e Obiliqit arsimimi është i organizuar në gjashtë shkolla fillore në gjuhën shqipe, katër shkolla fillore në gjuhën serbe dhe dy shkolla të mesme, numri i objekteve shkollore gjithsej është njëzetënjë (21), duke përfshirë edhe shkollat e mesme. Në procesin mësimor janë të përfshirë rreth 5573 nxënës.

Në vitin 2002 u krijua një model i ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e reformuar ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të ulët të mesëm dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të lartë të mesëm. Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re, arsimi i obligueshëm është zgjatur për një vit, tani në 9 vite nga ai i mëparshmi me 8 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor është e organizuar në katër nivele: Arsimin parashkollor (V-VI vjeçar), arsimin fillor (I-V), arsimin e mesëm të ulët (VI-IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X-XII).

Për fëmijët e moshës nën 5-vjet brenda territorit të Komunës është e organizuar një çerdhe. Arsimi para-fillor e hasim tek një numër i konsiderueshëm i shkollave fillore që ofrojnë edukim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeç.

Raporti nxënës-mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 20 nxënës, mesatarja për një (1) mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën.

Sa i përket kushteve fizike të objekteve shkollore ato ndryshojnë nga njëri vendbanim në tjetrin. Në aspektin e përgjithshëm të mësim-nxënies kushte jo të kënaqshme na paraqiten në vendbanimet e thella rurale.

Këto objekte shkollore kanë nevojë për investime, renovim, ujësjellës, kanalizim, për rregullim të oborreve dhe të fushave sportive, pajisje me laboratorë, kabinete dhe punëtori me mjete të nevojshme arsimore.

Tabela 2. Numri i shkollave, numri i nxënësve dhe kushtet mjedisore

Nr	Vendi	Emri i shkollës	Nr. i nxënësve			Gjendja me ujë dhe rr. i kanalizimit		Poligonet sportive
			M	F	Gj	uji nga :	ambienti i jashtëm	
1	Obiliq	“Rrita jonë”	36	44	80		I rregulluar	
2	Obiliq	“Pandeli Sotiri”	586	593	1179		I pa rregull	
3	Obiliq i vjetër	“Pandeli Sotiri”	131	142	273		I pa rregull	
4	Mazgit i Epërm	“Pandeli Sotiri”	124	119	243		I pa rregull	Mungon
5	Mazgit i Poshtëm	“Pandeli Sotiri”	78	86	164		I pa rregull	Mungon
6	Plemetin	“Pandeli Sotiri”	58	63	121		I pa rregull	Mungon
7	Millosevë	“Liria”	311	344	655		I rregulluar	Mungon
8	Raskovë	“Liria”	40	46	86		I pa rregull	Të rregullohet
9	Breznice	“Naim Frashëri”	159	163	322	pusi	I rregulluar	
10	Kozaricë	“Naim Frashëri”	56	45	101	pusi	I pa rregull	Mungon
11	Hade	“Fazli Graçevci”	51	41	92		I pa rregull	
12	Palaj	“Fazli Graçevci”	40	38	78		I pa rregull	
13	Lajthishtë	“Fazli Graçevci”	66	63	129		I pa rregull	
14	Sibofc	“Migjeni”	79	84	163		I pa rregull	
15	Shipitullë	“Migjeni”	46	26	72	pusi	I pa rregull	Mungon
16	Grabofc	“Migjeni”	19	13	32	pusi	I pa rregull	
17	Dardhishtë	“Abdurrahman Gërguri”	112	109	221		I pa rregull	
18	Obiliq	“Branko Radicevic”	16	18	34		I pa rregull	Mungon
19	Plemetin	“Sveti Sava”	150	130	280		I pa rregull	
20	Cerkvena Vodice	“Dositej Obradovic”	9	14	23		I pa rregull	
21	Baibimovc	“Milan Rakic”	40	47	87		I pa rregull	
G:	21		1461	2184	4355			
1	Obiliq	“Hasan Tahsini”	476	206	682		I pa rregull	
2	Obiliq	“17 Shkurti”	110	201	311		I pa rregull	
3	Plemetin	“Sveti Sava”	58	87	145		I pa rregull	
			644	494	1138			
Gj			2851	2722	5573			

### 1.1.1 Edukimi mjedisor

Shkolla si qendër edukimi është bazë e edukimit qytetar dhe atij mjedisor të nxënësve. Në përgjithësi, në kuadër të edukimit qytetar, nxënësit marrin në shkollë dhe njohuri për edukimin mjedisor.

Edukimi mjedisor duhet të nisë që në ciklin fillor dhe të vazhdojë gjatë gjithë shkollimit të nxënësve. Edukimi mjedisor në shkollë e bënë ndërgjegjësimin e nxënësve për të gjitha llojet e shkatërrimeve dhe ndotjeve që po ndodhin sot në Komunë. Edukimi mjedisor sot është, si një parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit. Duke parë problemet mjedisore me të cilat po përballet sot Komuna, të cilat janë rezultat i një zhvillimi të pakontrolluar dhe degradues ndaj mjedisit dhe edukimi mjedisor shihet si përparësi, si një mjet kryesor për një qeverisje më të mirë të mjedisit. Çdo ditë e më shumë edhe në Komunën tonë lëvizja dhe edukimi mjedisor i komunitetit po marrin vendin e duhur. Mjedisit dhe mbrojtja e tij nuk duhet të konsiderohen si çështje që i takojnë “shtetit” dhe “të tjerëve”, por të gjithë komunitetit, pasi edhe ndikimi është i gjithanshëm.

Edukimi mjedisor synon rritjen e përgjegjësisë individuale në marrjen e vendimeve dhe formulimin e një kodi sjelljeje për çështjet që lidhen me cilësinë e mjedisit dhe ruajtjen e tij. Edukimi mjedisor realizohet në dy drejtime kryesore:

- Në ndërgjegjësimin e shoqërisë se mjedisit ndikon mbi individin dhe të gjithë individët me zgjedhjet dhe sjelljet e tyre çdo ditë ndikojnë mbi mjedisin.
- Të kuptuarit nga gjithkush se duhet të bëjë çmos dhe të veprojë për të zvogëluar riskun e dëmtimeve që shkaktohen në mjedis nga faktorë të ndryshëm.
- Zbatimi i projekteve dhe planeve informuese, ndërgjegjësuëse dhe edukuese duhen aplikuar sa më shpejt dhe me përgjegjësi, për të shmangur dhe zgjidhur problemet e shumta, gjithnjë e më prezentë në mjedis.

Por, edukimi i përvetësuar mjedisor është i pamjaftueshëm për shumë arsye: mungesa e materialeve të shkruara, mungesa e një organizimi të aktiviteteve të përbashkëta, mangësitë në dhënien dhe marrjen e informacionit mjedisor, mungesa e qendrave të informimit mjedisor etj.

Me gjithë përpjekjet e deritanishme, ka mangësi në organizimin e aktiviteteve për edukimin mjedisor. Disa shoqata mjedisore janë përpjekur të rrisin edukimin mjedisor të nxënësve, por mungesa e fondeve ka krijuar vështirësi për zhvillimin e mëtejshëm, e të vazhdueshëm të këtij procesi.

## 1.2. Shëndetësia

Në territorin e Komunës, në sektorin publik shëndetësia është e organizuar në nivelin parësor. Shërbimet shëndetësore ofrohen në 8 objekte shëndetësore, ku një prej tyre është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare e cila ndodhet në Obiliq, ndërsa të tjerat janë Qendra të Mjekësisë Familjare të cilat ndodhen në: Milloshevë, Plemetin, Breznicë, Palaj dhe Sibovc, dhe Ambulanca në Shipitullë dhe Babimoc.

Sa i përket gjendjes fizike të objekteve shëndetësore kjo ndryshon nga njëri objekt në tjetrin, por në përgjithësi kanë një gjendje të konsiderueshme.

Gjithashtu, duhet cekur se në këtë territor ofrohen shërbime mjekësore edhe nga sektori privat. Gjendja e mirë shëndetësore është shumë e varur edhe nga indikatorët mjedisor, në radhë të parë nga ajri, uji për pije, si në aspektin sasior, ashtu edhe në atë cilësor.

Numri i problemeve shëndetësore që vijnë si pasojë e ekspozimit ndaj mjedisit është gjithnjë në rritje, posaçërisht të fëmijët. Më herët ka qenë e mundur të vendoset një lidhje e saktë mes disa efekteve në shëndet dhe faktorëve mjedisor. Mirëpo, edhe sot e kësaj dite mungon një pasqyrë e përgjithshme e ndikimeve në shëndet që rezultojnë nga ekspozimet komplekse jetësore.

Tabela 3. Të dhënat e rasteve të reja të sëmundjeve të cilat paraqiten si pasojë e ndotjes së ajrit dhe ujit

Viti / Sëmundjet	2010	2011
F00-F48-shëndeti mental	145	47
E10-E14-sëmundja e sheqerit	50	144
N03-N18-sëmundjet kronike të veshkave	9	0
I20-I25-sëmundjet e zemrës	26	59
J42-J47-sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	55	45
Sëmundjet malinje-kanceri	14	17
<b>SËMUNDJET NGJITËSE</b>		
Pneumonia	204	217
Diarreja - barkë-qitjet	864	954
Dyshimi në grip	8	309
TBC	0	2
Hepatiti-A	2	1

### 1.2.1. Rreziqet shëndetësore dhe mjedisi

Nëse bëhet krahasimi i pjesëmarrjes së sëmundjeve respiratorë në sëmundjet e përgjithshme nëpër viset tjera më pak të ndotura të Kosovës, ku sëmundjet e organeve respiratorë të evidentuara në QKUK dhe në spitalet rajonale të Kosovës për grup-moshat mbi 18-vjet është rreth 14.26 %, ndërsa në Obiliq me rrethinë është rreth 30 %, atëherë mund të konkludojmë me siguri se termoelektranat gjatë gjithë këtyre viteve jo vetëm që kanë shkaktuar një ambient të ndotur dhe të dëmshëm, por në mënyrë të drejtpërdrejt kanë ndikuar në kualitetin e jetesës, shëndetin e njerëzve dhe shkurtimin e jetës.

Dëmtimi i shëndetit zakonisht rritet me rritjen e nivelit të emitimit dhe kohëzgjatjen e ndotjes së ambientit. Pra, edhe emitimet afatshkurta të koncentrimëve të mëdha të ndotësve, si dhe emitimi afatgjatë me përqendrime të vogla në ajër mund të shkaktojnë çrregullime të caktuara të shëndetit të popullatës. Sipas mendimit të disa ekspertëve të mjekësisë sociale, veprimi afatgjatë i materieve të dëmshme me përqendrim të vogël paraqet rrezik më të madh për shëndetin e njerëzve për arsye se përqendrimet e vogla tolerohen për shkak të mungesës së paraqitjes dramatike të sëmundjeve dhe vdekshmërisë, ndërsa veprimet afatshkurta të këtyre dëmtuesëve vërehen menjëherë dhe për pasojë edhe ndërmarrja e masave mbrojtëse është më e shpejtë.

Gjatë procesit të djegies së qymyrit përveç emitimit të ndotësve të njohur si pluhur fluturues, thërrmija të pluhurit, SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, blözë etj., ato emitojnë edhe grimca organike kancerogjene (hidrokarburet policiklike), grimca të metaleve të rënda (merkur, plumb, arsen etj.).



Gjithashtu, nga deponitë e hirit për shkak të reagimit të hirit dhe ujit mund të ketë prezencë të radionuklidëve natyrale në ujin nëntokësorë.

### 1.2.2. Efektet shëndetësore nga ndotja e mjedisit

Kollitje, sulme astmatike, aritmi të zemrës, lindje të parakohshme, veset e lindura të zemrës, ku grimcat depërtojnë nëpërmjet të mushkërive në qarkullim të gjakut, pezmatim të sistemit kardio-vaskular, duke shkaktuar sulme në zemër, pikë në tru, lindje të parakohshme me peshë të vogël të frytit, çrregullime të sistemit nervor dhe dëgjimit, çrregullime të shtypjes së gjakut ritmit të zemrës, zvogëlon funksionin e mushkërive, çrregullime të sistemit nervor, dëgjimit etj.

## 1.3. KULTURA DHE SPORTI

### 1.3.1. Trashëgimia arkeologjike dhe kulturo-historike

Trashëgimia arkeologjike, arkitektonike dhe historike është shumë e rëndësishme për të kontribuar në zhvillim të qëndrueshëm, sidomos me pjesëmarrjen e saj në llojllojshmërinë (diversitetin) e zhvillimit të zonave rurale.

Në disa pjesë të Komunës sonë ka gjurmë të vendbanimeve të lashta. Ndonëse nuk janë bërë hulumtime arkeologjike të mirëfillta, megjithatë tashmë dihet që në Majën e Zezë në fillim të Çyçavicës, midis fshatrave Mjekaj, Shipitullë e Sibofc janë gjetur themele shtëpish, gurë të gdhendur, elemente metalesh, madje edhe grurë i karbonizuar, të gjitha këto gjetje që dëshmojnë për një vendbanim shumë të lashtë. Shumë nga objektet (dhe veçanërisht gurët) janë dëmtuar.

Është e nevojshme të bëhen hulumtime arkeologjike në territorin e Komunës.

Tyrbja e Sulltan Muratit të I-rë - është vënë nën mbrojtje institucionale që në vitin 1950 dhe gjendet rreth 6 km. në periferi të Prishtinës, në anën e majtë të magjistrales Prishtinë-Mitrovicë, në fshatin Mazgit.



Figura 2. Tyrbja e Sulltan Muratit dhe ndërtesa për Selamlık (Selamlık)

Tyrbja e Sulltan Muratit ose Meşhed-i Hüdâvendigâr është ndërtuar në shekullin XIV dhe paraqet veprën më të vjetër Otomane në Kosovë.

Për vlerat e saj kulturore, historike dhe arkitektonike është shpallur monument dhe mbrohet me ligjin mbi trashëgiminë kulturore. Pranë Tyrbes, në vitin 1896, ishte ndërtuar objekti për pushimin dhe bujtjen e vizitorëve të saj, të quajtur Selamllëk (Selamlık). Tyrbja është rinovuar disa herë më parë, por ky më i fundit, në vitin 2005, është rinovim më i rrënjësishëm dhe i financuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame e Republikës së Turqisë.

Tërësitë dhe objektet e njohura të kësaj trashëgimie janë paraqitur me vendndodhjen e tyre hapësinore në tabelën në vijim:

Tabela 4. Lokacionet e pronave kulturore

Vendbanimet	Monumentet e trashëgimisë kulturore-historike dhe kultit fetar
Obiliq	Monumenti i martirëve të lirisë Monumenti nga Lufta e Dytë Botëror. Xhamia Kisha në Obiliq Shtëpia e Kulturës (KEK) Shtatorja e atdhetarit Aziz Zhilivoda Busti i komandantit Adem Jashari Busti e dëshmorit të kombit Fahri Fazliu
Obiliq i vjetër	Xhamia
Mazgit i ultë	Monumenti i Ferid Currit Xhamia
Mazgit i epërm	Monumenti i luftëtarëve të Kosovës Tyrbja e Sulltan Muratit Tyrbja e Bajraktarit (Gazi Pashës)
Hade	Monumenti i martirëve të UÇK-së Xhamia në Hade
Hamidi	Xhamia (nga shek.-XVIII) Shtëpia Muze në Hamidi Lapidari i lirisë
Sibovc	Xhamia Varrezat e dëshmorëve
Grabovc	Xhamia Mulliri i ujit (i Hysenajve) Mulliri i ujit (i Behramajve) Pllakë përkujtimore e dëshmorit Fejzullah Graiqevci Pllakë përkujtimore e dëshmorit Faik Mjeku
Shipitullë	Monumenti i luftës (UÇK)
Millosevë	Xhamia (nga shek.-XVIII) Shtëpia e kulturës
Bajmovc	Kisha ortodokse
Breznicë	Xhamia
Plemetinë	Qendra rinore Kisha ortodokse
Dardhishtë	Xhamia
Bakshi	Xhamia
Kozaricë	Xhamia



### 1.3.2. Fushat sportive ekzistuese-publike

Tabela 5. Fushat sportive ekzistuese

Nr.	Fushat sportive:	Vendi	Numri i fushave sportive	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
1.	Fusha sportive	Obiliq	3	15000 m <sup>2</sup>
2.	Fusha sportive	Mullosheve	1	500 m <sup>2</sup>
3.	Fusha sportive	Babimofcë	1	500 m <sup>2</sup>
4.	Fusha sportive	Plemetin	1	500 m <sup>2</sup>
5.	Fusha sportive	Raskovë	1	500 m <sup>2</sup>
6.	Ballon salla	Plemetin	1	800 m <sup>2</sup>
7.	Poligoni sportiv	Obiliq	2	1600 m <sup>2</sup>
8.	Halla sportive	Obiliq	1	4000 m <sup>2</sup>
9.	Salla e edukatës fizike	Obiliq	1	450 m <sup>2</sup>

Tabela 6. Fushat sportive ekzistuese-private

Nr.	Fushat sportive ekzistuese:	Vendi	Nr. i fushave sportive	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
1.	Qendra trajnuese "Katana"	Obiliq	1	1800 m <sup>2</sup>
2.	Ballon salla e mbyllur	Milloshëvë	1	800 m <sup>2</sup>
3.	Ballon salla e mbyllur	Raskovë	1	800 m <sup>2</sup>

Tabela 7. Poligone sportive në shkolla

Nr.	Fushat sportive ekzistuese:	Vendi	Nr. i fushave sportive	Sipërfaqja në m <sup>2</sup>
1.	Poligoni Sportiv	Obiliq	1	800 m <sup>2</sup>
2.	Poligoni sportiv	Breznicë	1	800 m <sup>2</sup>
3.	Poligoni sportiv	Babimofcë	1	800 m <sup>2</sup>
4.	Poligoni sportiv	Plemetin	1	800 m <sup>2</sup>
5.	Poligoni sportiv	Raskovë	1	800 m <sup>2</sup>
6.	Poligoni sportiv	Sibofcë	1	800 m <sup>2</sup>
7.	Poligoni sportiv	Palaj	1	800 m <sup>2</sup>
8.	Poligoni sportiv	Hade	1	800 m <sup>2</sup>
9.	Poligoni sportiv	Lajthishtë	1	800 m <sup>2</sup>
10.	Poligoni sportiv	Dardhishtë	1	800 m <sup>2</sup>
11.	Poligoni sportiv	Obiliq	1	800 m <sup>2</sup>
12.	Poligoni sportiv	Llazarevë	1	800 m <sup>2</sup>

Mungesa e hapësirave për sporte të ndryshme në natyrë. Përveç stadiumit aktualisht mungojnë fushat sportive të lojërave me top dhe sporteve të tjera në natyrë, mungojnë pishinat.

## 2. ZHVILLIMI EKONOMIK

Komuna e Obiliqit është qendër e zhvillimit ekonomik të sektorit energjetik në Kosovë. Bartësit kryesorë të zhvillimit ekonomik në Komunën e Obiliqit sot janë prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralet TC-A dhe TC-B, zhvillimi i aktiviteteve minerare në minierat e thëngjillit, toka bujqësore e kategorisë I-IV dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë-Mitrovicë.

### 2.1 SEKTORI ENERGJETIK

#### 2.1.1 Eksploatimi i linjtit

Eksploatimi i linjtit është duke u bërë që gati 100 vjet dhe operacionet e mëdha siç shihen sot me mihje sipërfaqësore dhe prodhim të energjisë elektrike kanë funksionuar që gati 50 vjet, pa ndonjë brengë për ndikimet në popullsi dhe mjedis.

Veprimtarin ekonomike mbi këtë bazë e ushtron Korporata Energjetike e Kosovës - KEK sh. a. Minierat, TC-të dhe lokacionet e deponive janë prona të KEK sh. a.



Figura 3. Pamje nga mihja sipërfaqësore e linjtit dhe simbolet e Korporatës Energjetike të Kosovës

Zona e KEK-ut gjendet mes luginës së lumit Sitnicë në lindje me lartësi mbidetare prej rreth +525 metra dhe një vargmal që zgjerohet në jug me lartësi mbidetare që shkon në +750 metra, kurse në anën perëndimore vazhdon të rrethohet me luginën e lumit Drenica me lartësi mbidetare të shtrirjes prej rreth +550 metra.

Të dyja minierat aktivitetet e tyre i kanë zhvilluar në të njëjtën zonë, duke avancuar në drejtime të kundërta. Në vitin 2005 ishte e domosdoshme të ndërmerren masa ristrukturimi, ngase dy mihjet e hapura sipërfaqësore të Bardhit e Mirashit ndërthureshin më masë të shtuar. Që atëherë të dyja mihjet e hapura sipërfaqësore zhvillohen si një minierë e vetme. Sido që të jetë, minierat edhe më tej quhen sipas emrave të tyre origjinal. Kanë filluar aktivitetet minerare në dy miniera të reja në Sivocin JP (në veri të Bardhit) dhe në sektorin Sitnica, afër fshatit Dardhishtë.

### 2.1.2 Termocentralet

TC A ka 5 blloqe të cilat janë ndërtuar në dy faza (nga 1962 deri 1964 dhe nga 1970 deri 1975). TC B ka dy (2) blloqe që janë ndërtuar nga 1983 deri 1984. Dy termocentralet janë të ndryshme në kuptim të ndikimeve mjedisore për shkak të dallimit në moshë dhe teknologjisë. Ngjitur me TC A gjendet një zonë e braktisur industriale, ku kanë qenë në veprim impianti i gazifikimit të thëngjillit dhe azotikut deri para më shumë se 10 vjetëve.



Figura 4. Pamje e liritimit të gazrave nga TC A dhe TC B

## 2.2 Tregtia

Tregtia në këtë zonë është bërë sektori më aktiv, sidomos në dekadën e fundit. Tregtia ka marrë hov në zhvillimin e saj në formë të bizneseve të vogla dhe të mesme. Ndërsa, shumica e ndërmarrjeve apo bizneseve të regjistruara në lokalitetet e fshatrave të kësaj komune janë biznese të vogla tregtare që kanë të punësuar 2-3 persona.

Autoritetet në Komunën e Obiliqit kanë ndërmarrë aktivitete të shumta për zhvillimin e mirëfilltë të bizneseve, duke filluar nga: lehtësimi i qasjes në lokacion, dhënia e pëlqimit për plotësimin e kushteve ambientale, lejet e punës dhe tarifave të kapshme për biznese. Nga të dhënat e regjistrimit të bizneseve rezulton se sektori i tregtisë është dominues ndaj sektorëve të tjerë.

## 2.3 Bujqësia

Si biznese, aktivitetet bujqësore në sektorin e bujqësisë, nuk figurojnë të regjistruara, mirëpo është e evidente se ato janë ndër aktivitetet primare familjare. Në Komunë, bujqësia është zhvilluar tradicionalisht nga familjet e mëdha dhe ka qenë aktiviteti kryesor ekonomik jashtë sektorit të energjisë dhe minierave. Përafërsisht 60 % e popullatës që jetojnë në këtë rajon janë bujq që kultivojnë kryesisht grurin dhe misrin. Korrja dhe bluarja e drithërave kryesisht është e rregulluar në formë kooperative dhe në formë individuale. Nuk ka ndonjë fermë të madhe blegtorale, mirëpo kryesisht ka ferma të vogla dhe të mesme. Pronësia e tokës ndryshon sipas vendbanimeve, por shumica e banorëve kanë tokën në pronësi ku ata jetojnë dhe oborre e kopshte të vogla rreth shtëpisë që shfrytëzohen për prodhime bujqësore të nevojave vetanake. Sidoqoftë, rëndësia ekonomike e bujqësisë në zonë është në rënie. Sot shumë fusha me tokë kualitative bujqësore janë të lëna djerrë dhe shumica prodhojnë vetëm për konsum familjar.

Klima mesdhetare krijon mundësi për rritjen dhe zhvillimin e një bimësie të shumtë e të larmishme si ajo e arave, perimeve, bimëve etero vajore, hardhia etj.

Kulturat kryesore bujqësore janë: grurë, elbi, misër, tërshërë, bimë industriale, patate, perime, foragjerë, e të tjera.

Përgjithësisht, rendimentet në prodhimet bujqësore janë të ulëta për disa arsye si:

- Nuk ka farëra me aftësi të larta prodhuese;
- Nuk funksionon sistemi i ujitjes;
- Plehurat kimike janë në sasi të pakta dhe;
- Nuk përdoren sasi të duhura të pesticideve.

Përveç efekteve negative në uljen e të ardhurave të familjeve që ushtrojnë këtë aktivitet, rendimentet e ulëta si rezultat i mos përdorimit të plehrave kimikë dhe pesticideve ndikojnë në ruajtjen e një mjedisi më cilësor dhe më pak të ndotur. Cilësia e këtyre produkteve (ndonëse jo me pamjen më tërheqëse në treg) është shumë më e mirë se sa ajo e zonave me intensitet të lartë të përdorimit të luftës kimike dhe plehërimit artificial.

### 2.3.1 Blegtoria

Blegtoria në Komunë është në kufij mjaft të ulët të zhvillimit. Nga blegtoria mund të sigurohen të ardhura e produkte të shumta, si mishi, qumështi, leshi, lëkura etj., të cilat sjellin të ardhura ekonomike të mira për familjet që merren me këtë aktivitet.

Në vitet e fundit kemi një ulje drastike të numrit të krerëve.

Kjo ka ardhur për shumë arsye:

- Rënia e interesit për të ushtruar aktivitetin blegtoral;
- Mungesa e investimeve për përmirësime racore dhe;
- Mosfunksionimi i institucioneve që kryenin ose ndihmonin në përmirësimet racore.

### 2.4 Pylltaria

Pyjet, në territorin e Komunës, zënë një hapësirë prej 1.153 ha ose marrin 11 % nga sipërfaqja e tërësishme e saj. Në pjesën perëndimore shtrihen pyje të ulëta që mbulohen nga brezi i pyjeve kserotermofile dhe mezotermofile të dushqeve dhe lloje të tjera si: Shpardi – *Quercus Frainetto*, Qarri – *Quercus Cerris*, Shkoza e zezë - *Carpinus Orientalis*, Ahu – *Fagus Moesiaca*.

#### 2.4.1 Shkatërrimi i pyjeve dhe kullotave

Prerja pa kriter e pyjeve dhe djegia e tyre prej veprimtarisë njerëzore ndikon direkt në prishjen e ekuilibrave ekologjikë. Për këtë duhet rritur shkalla e ndërgjegjësimit të njerëzve për dëmin që po i shkaktojnë natyrës, si rrjedhojë dhe shëndetit të tyre. Gjithashtu, duhen bërë përmirësime ligjore me qëllim që pyjet dhe kullotat të kalojnë në pronësi të Komunës, pasi kujdesi ndaj tyre do të jetë shumë më i madh.

## 2.5 Turizmi

Turizmi në Komunë nuk ka ndonjë zhvillim të dukshëm. Pasi që Komuna e Obiliqit konsiderohet të jetë një nga zonat me mundësi më të mëdha të zhvillimit të industrisë, se sa të sektorëve të tjerë të ekonomisë. Turizmi si sektor ka zhvillim të limituar. Përjashtim bën turizmi kulturor, por ky lloj i turizmit ka një sezon shumë të shkurtër dhe turizmi ditor. Një nga monumentet kulturo-historike të rëndësishme së madhe është “Tyrbja e Sulltan Muratit” në fshatin Mazgit.

Mali i Qyqavicës, i cili gjendet në pjesën veri-perëndimore të Komunës, ka mundësi të zhvillimit të turizmit të gjetisë.

## 3. MJEDISI

### Situata aktuale në mjedis

Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në territorin e Komunës së Obiliqit. Niveli i lartë i emitimeve të gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e thëngjillit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit. Mostrajtimi i ujërave nga procesi teknologjik, ujërave që rrjedhin nga minierat sipërfaqësore, gjendja jo e mirë e rezervarëve dhe baseneve të ujërave fenolike dhe fenolit të koncentruar në zonën e gazifikimit dhe shpëlarja e tokës nga të reshurat atmosferike, në tërë zonën e KEK-ut, e cila gjatë kohës është ndotur me fenole, shkakton në masë të madhe ndotjen e lumit Sitnica, me theks të veçantë me fenole. Probleme shtesë janë edhe deponitë e hirit të cilat akumulojnë më shumë se 40 milionë tonelata hi, duke uzurpuar kështu rreth 242 ha tokë punuese, deponia nga TC “Kosova-A” dhe 150 ha deponia TC “Kosova-B”, si dhe gropat e hapura gjatë mihjeve sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit.

Aktivitetet minerare dhe gjenerimi i energjisë elektrike në të kaluarën, por edhe tani shkaktojnë ndotje të ashpër të mjedisit, ajrit, ujit, tokës, emitime të zhurmës dhe degradim të biodiversitetit natyror në territorin e Komunës. Ndotja e mjedisit karakterizohet edhe nga aktivitet urbane siç janë trafiku në komunikacion, menaxhimi joefikas i planifikimit hapësinor të territorit, trajtimi i ujërave të zeza-sanitare, si dhe menaxhimi jo i mirë i mbeturinave komunale.

### 3.1. Ajri

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut. Mirëpo, që nga revolucioni industrial kualiteti i ajrit që e thithim ka rënë konsiderueshëm - kryesisht si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Ngritja e prodhimit industrial dhe energjetik, djegia e karburanteve fosile, si dhe rritja dramatike e trafikut kanë shtuar edhe më shumë ndotjen e ajrit, çka si rrjedhojë mund të shkaktojë probleme shëndetësore serioze.

#### 3.1.1. Burimet e ndotjes së ajrit në territorin e Komunës janë:

- Ndotja e ajrit nga aktivitetet minerare dhe minierat e qymyrit (linjtit);
- Ndotja e ajrit nga prodhimi i energjisë elektrike në TC-A dhe TC-B;
- Ndotja e ajrit nga deponimi i hirit dhe;
- Ndotja e ajrit nga komunikacioni dhe sistemet ngrohëse banesore.



### 3.1.2. Vlerësimi i shkaqeve dhe problemet (kërcënimet) në cilësinë e ajrit

Zjarret si shkak i djegies spontane të linjtit ndodhin në sistemin e tavaneve të mihjeve sipërfaqësore të Mirashit dhe Bardhit dhe më rrallë në ballët e mihjes, dhe përgjet e palosjes së linjtit. Tavaneve të linjtit ndizen për shkak të oksidimit të sulfurit të djegshëm, i cili në kontakt me oksigjenin atmosferik prodhon energjinë e nxehësive së nevojshme për vetëdezhje.

Pluhuri/thërrmijat janë burimet më të mëdha të ndotjes së ajrit nga aktivitetet minerare, ekskavatorët, kamionët si dhe rrugët e pashtruara në miniera.

Prodhimi i energjisë elektrike në TC-A dhe TC-B me një performancë të dobët mjedisore Filtrat elektrostatische për reduktimin e thërrmijave të ngurta janë të instaluar në të dyja termocentralet, megjithatë filtrat e instaluar funksionojnë me efikasitet shumë më të vogël, sesa kriteret e parapara. Nuk ka asnjë impiant për reduktimin e SO<sub>2</sub> (De-sulfurues) dhe NO<sub>x</sub> (De-Nox-ues) në TC-A dhe TC-B.

Zgryra dhe hiri fluturues janë deponuar në mënyrën më të lehtë dhe më të lirë, pa i kushtuar vëmendje në shqetësimet mjedisore. Vetëm kohëve të fundit hiri nga “Kosova B” është transportuar në mënyrë hidraulike në minierën pasive e shterur të Mirashit lindor. Siç u tha më herët, dy lokacionet e deponimit për zgjyrën dhe hirin fluturues janë përdorur jashtë normativave, pranë lokacionit të “Kosovës A dhe B” ku grumbujt e formuar nga hiri krijojnë një element shumë iritues dominues në aspektin vizual në peizazh. Deponitë e hirit tejkalojnë vëllimin e synuar fillestar, duke përcaktuar edhe probleme të stabilitetit në të dy deponitë. Lartësia e dizajnuar maksimale e deponisë për TC B ishte 15 metra, por sot lartësia e deponisë është mbi 70 metra.

Zonat e okupuara me deponi të hirit janë afro 240 hektarë për TC A (përfshirë djerrinën) dhe 74 ha për TC B.

Paraqitja e pluhurit nga palosja e hirit rezulton kryesisht gjatë deponimit aktiv të hirit. Përpos erës që ndihmon në shpërndarjen e pluhurit nga shiritat transportues, një burim tjetër konstant i pluhurit janë edhe palosësit të vendosur diku rreth 10 m deri 20 m mbi palosjen që pranohet.

Vlerësohet se për një vit rreth 80 % të prodhimit të pluhurit lidhet me procesin e palosjes dhe vetëm rreth 20 % e pluhurit krijohet nga hiri i palosur gjatë kohës së erërave të forta.

Ka pak informata në dispozicion për numrin e automjeteve motorike për km rrjet rrugor, llojin e veturave dhe formën kryesore të sistemeve ngrohëse, duke e vështirësuar kështu parashikimin e ndikimit real të këtij lloji të emetimit në cilësinë e ajrit në këtë zonë.

Veturat në Kosovë janë përgjithësisht të vjetra, në klasën e emetimeve Euro-1 deri në Euro-3, si pasojë, shkalla emetuese specifike për veturë duhet të jetë mjaft e lartë.

Cilësia e rrugëve e problematikat që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshmërinë e tyre dhe të parkimeve kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet.

### 3.1.3. Kontrolli-Monitorimi i kualitetit të ajrit

Të dhënat mbi cilësinë e ajrit në territorin e Komunës janë të kufizuara dhe jo-sistematike. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës nuk ka pikë monitoruese në territorin e Komunës.

Është duke u zbatuar një pilot-projekt që ka për qëllim trajnimin e stafit profesional të IHMK-ës, i mbështetur nga USAID-i, i cili bën monitorimin e cilësisë së ajrit në lokacione brenda territorit të Komunës.

Instituti INKOS bënë matjet dhe paraqet pasqyrën mbi gjendjen mjedisore në disa pika të për-

caktuara, gjegjësisht përqendrimin e imisioneve (ndotësve kryesor) në ajër, përfshirë SO<sub>2</sub>, blozën, thërrmijat ajrore dhe pluhurin e depozituar (sedimentet), të cilat raportohen në KEK. Nuk ka matje të vazhdueshme mbi NO<sub>x</sub>-in

Nga të dhënat e pasqyruarave nuk mund të konsiderohen si pasqyrim i plot i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit.

Sipas Memorandumit për themelimin e Unionit Energjetik (Memorandumi i Athinës), i nënshkruar edhe nga Kosova (22 mars 2005), kërkesat e Direktivës 2001/80/EC duhet të përmbushen deri më 31 dhjetor 2017.

Emissionet aktuale të termocentraleve të KEK-ut sipas direktivës 2001/80/EC duhet të arrihen sipas standardeve të cekura në tabelën në vijim.

Tabela 8. Emissionet<sup>1</sup> dhe limitet sipas Memorandumit të Athinës

<b>Ndotësi</b>	<b>Limiti</b>	<b>Të arrihet</b>
Pluhur	50	31 dhjetor 2017
SO <sub>2</sub>	400	31 dhjetor 2017
NO <sub>x</sub>	500	31 dhjetor 2017

Rezultatet e monitorimit të gjendjes mjedisore të cilat monitorohen si detyrim ligjor janë të bashkangjitur si shtojcë në PLVM-së.

### 3.1.4 Problemet me prioritet

- Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit, pluhurit fluturues, thërrmija të pluhurit, bloza, SO<sub>2</sub> dhe NO<sub>x</sub>, nga termocentralet ekzistuese, aktivitetet minerare dhe deponitë e hirit, të cilat nuk janë në pajtueshmëri me standardet mjedisore që dalin nga Direktiva e BE-së për impiante me djegie të mëdha (LCPD 2001/80/EC).
- Lirimi i gazrave serrë nga deponija rajonale e Prishtinës në Mirash.
- Të dhënat nga monitorimi i kualitetit të ajrit janë të kufizuara dhe jo-sistematike, si pasqyrim i plot i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit, nuk ka monitorim të vazhdueshëm i cilësisë së ajrit.
- Cilësia e rrugëve dhe problematikat që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshmërinë e tyre dhe të parkimeve kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit, dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet.

## 3.2 UJI

### Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Në territorin e Komunës ekzistojnë tre lumenj natyror që janë: “Sitnica”, “Drenica” dhe “Llapi”. Si dhe një kanal artificial që është Kanali Iber-Lepenc, i cili vjen nga liqeni akumulues i Ujmanit nga rrjedha e lumit “Iber”. Lumi “Sitnica” përshkon territorin e Komunës nga jugu në veri dhe është ujëmbledhësi i 80 % të ujërave në drejtim të veriut. Lumi “Sitnica” derdhet në lumin “Ibër” në Mitrovicë.

<sup>1</sup> Njesia në: mg/Nm<sup>3</sup> 6% O<sub>2</sub> i thatë

Lumi “Drenica” rrjedhë në perëndim dhe derdhet në lumin “Sitnicë” para hyrjes në jug në territorin e Komunës. Lumi “Llap” rrjedhë në lindje, i cili derdhet në lumin “Sitnicë” në veri të territorit të Komunës. Lumi “Sitnicë” është lumë fushor me pjerrtësi të vogël, me shtrat të gjerë, të cektë dhe me gjarpërime, veçohet me prurje të vogla vjetore të ujit. Gjatë stinës së verës nuk ka prurje më të madhe se 2.5 m<sup>3</sup>/s, kurse gjatë stinës së dimrit dhe në pranverë, kur bëhet shkrirja e bores, kjo prurje është 15 herë më e madhe, përkatësisht 37.5 m<sup>3</sup>/s. Gjatë prurjeve të mëdha të ujit, lumi “Sitnica” del jashtë shtratit dhe përmbytë sipërfaqe të tokave punuese për rreth, duke i shkaktuara dëme të mëdha bujqësisë.

Vetë fusha e mihjeve mbulon gjashtë zona ujëmbledhëse të zonave më të vogla ujore; katër prej tyre që rrjedhin në drejtim të lumit “Sitnicë” në lindje dhe dy në drejtim të lumit “Drenica” në perëndim. Përgjatë lumit “Sitnicë” shtrihet një fushë, që përmbytet me ujë në sezonin e reshjeve të mëdha, në të cilën gjendet lokacioni i zonës industriale ku janë vendosur dy (2) blloqet e TC “Kosova B”.

Lumi “Sitnicë” është i ndotur nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij nga shkarkimet urbane, e përveç tyre edhe nga efluentët nga termocentralet dhe mihjet e KEK-ut, të cilat shkarkohen direkt, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit.

Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë përmbajtje të madhe të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose fare pak trajtim të ujërave të zeza. Të dhënat e përpiluara së mbi pikat e shkarkimit dhe marrjes së mostrave të cilësisë së ujit tregojnë që uji i lumit “Sitnicë” duhet kategorizuar si Ujë i Klasës IV, sipas sistemit të klasifikimit (pra, “ujë që mund të përdoret vetëm pas një trajtimi special”) dhe është larg nga standardet evropiane të cilësisë.

### 3.2.1. Burimet kryesore të ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Ujërat e ndotura industriale paraqesin një prej ndotësve të mëdhenj të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Burimet kryesore të ndotjes janë: ujërat e kontaminuar nga minierat e thëngjillit.

Ujërat e shkarkuara nga “T.C. Kosova (A dhe B)” përfshijnë drenazhimi i ujërave nga deponitë e hirit.

Ujërat e minierave të Bardhit dhe Mirashit kanë origjinë nëntokësore dhe sipërfaqësore me qëllim eksploatimi i linjtit bëhet nën nivelin e lumenjve “Drenica” dhe “Sitnica”. Ujërat e shiut të grumbulluara në sistemet e drenazhit grumbullohen në miniera. Nuk ka pëllgje për ujërat teknologjike nga minierat, por uji pompohet jashtë dhe shkarkohet në lumenjtë më të afërt (lumenjtë “Drenica” dhe “Sitnica”). Shpeshherë ujërat e minierave përdoren për të shuar zjarre në miniera. Një tjetër çështje e rëndësishme mjedisore është përqendrimi i shtuar i substancave të suspenduara në ujërat e minierave që arrijnë 900 mg/l, që tejkalon për 36 herë udhëzimet e standardet e BE-së për ujërat e populluara me peshq (25 mg/l). Përqendrimi i sulfatit në ujërat e mihjes, gjithashtu është mjaft i lartë (deri në 23 mg/l) dhe mund të dëmtojë florën dhe faunën e rrjedhjeve të tepërta. Përqendrimi i fenolit në ujërat e mihjes së Mirashit është në nivele të larta dhe tejkalon për 25 herë standardet e BE-së për ujë të pijshëm, që është 0.02 mg/l. Metalet e rënda janë brenda limiteve të përcaktuara maksimale për ujë të pijshëm sipas standardeve të BE-së, përveç vlerave të Ni, që janë pak më të larta (20 mg/l). Plumbi, gjithashtu, është afër limitit prej 10 mg/l. Lëshimi i sasive të larta të substancave toksike në një kohë të shkurtër mund të ketë ndikim në tërë sistemin ekologjik të lumenjve. Njëkohësisht, ndotja kronike me lëndë toksike të lëshuara në masa me përqendrim relativisht të ulët përgjatë periudhave të gjata mund të shkaktojë dëmtime të dukshme në sistemet lokale ekologjike. Termocentralet ekzistuese posedojnë pajisje për trajtim të pjesërisht të ujërave të ndotura industrial.



Ndotësit kryesorë në ujërat e ndotura teknologjike janë: mbetjet e lëndës djegëse, mbetjet e hirit, mbetjet e naftës dhe ato kimike, ujërat sanitare etj.

Këto mbetje përmbajnë kripëra dhe gjurmë metalike që mund të jenë të dëmshme për njerëzit dhe ekosistemin. Uji ftohës (avullimi dhe drenazhet nga sistemi i ftohjes) Përveç sasisë së ujit të avulluar nga proceset e kullave ftohëse, tërë ujërat e ndotura të prodhuara në “Kosovën A dhe B”, përfshirë ujërat industriale, ujërat sanitare dhe shiun shkarkohen në lumin “Sitnica” pa kurrfarë trajtimi paraprak.

Sistemet e shkarkimit përfshijnë 22 pika shkarkimi në sistemin kryesor të kanalizimit dhe 3 pikat kryesore të shkarkimit në lumin “Sitnica”.

Të gjitha ujërat sipërfaqësore të zonës së deponime që janë në kontakt me hirin dhe ndotësit tjerë në deponi po drenazhohen përmes shtratit të kanalit i cili kalon përgjatë vendbanimit me mundësi të vërshimeve të cilat po ndodhin në sezonet me të reshura të larta atmosferike, një përmirësim i shtratit të efluentëve përgjatë vendbanimit do të ndikonte edhe në evitimin e vërshimeve të cilat po ndodhin në sezonet me të reshura të larta atmosferike.

### 3.3 TOKA

#### 3.3.1 Toka dhe përdorimi i tokës

Komuna e Obiliqit është Komuna më ndikimin me të madh nga gjenerimi i energjisë elektrike, mihjes sipërfaqësore, deponimeve të hirit dhe të djerrinës, si dhe vendbanimeve, që ka nën shfrytëzim dhe pronësi private 56 % ose me 5.862 ha të sipërfaqes së tokës, kurse nën pronësi dhe menaxhim publik janë 4.620 ha ose 44%, nga e cila KEK-u posedon 15 %. Shfrytëzimi i tokës në territorin e Komunës ka rëndësi të madhe dhe nënkupton destinimin e sipërfaqeve apo llojin e nxënies së hapësirës, gjegjësisht të sipërfaqeve tokësore nën renditje të sektorëve nga të cilët shfrytëzohen ato. Në kuadër të territorit të Komunës është me rëndësi të dihet pjesëmarrja e pronësisë së tokës, në vijim në formë tabelare po e paraqesim përdorimin dhe destinimin e tokës.

Shfrytëzimi tokës	Sipërfaqja	(%)
Zona me potenciale bujqësore	6852 ha	65.4
Zona me pyje	1153 ha	11
Zona e banimit/vendbanimet	833 ha	8
Prona ujore	96 ha	0.9
Prona rrugore	247 ha	2.4
Zona e minierave në shfrytëzim	838 ha	8
Deponitë e hirit nga “Kosova A dhe B”	272 ha	2.5
Zona industriale - “TC Kosova A dhe B”	191 ha	1.82
Gjithsejtë:	10482 ha	100

#### 3.3.2 Ndotja dhe degradimi i dheut

Ekziston ndotje e dheut në zonën e ish-objekteve industriale energjetike, në lokacionin në afërsi të “TC Kosova A”, depozitimi i mbetjeve toksike të prodhimit (mbetjeve fenolike dhe blozës) në de-

poninë e hirit të “TC Kosova A”, si dhe punimeve të vjetra minerare nëntokësore. Këto kontaminime të hershme i janë nënshtruar një programi të gjerë të hulumtimit brenda Projektit të Pastrimit dhe Ri-Kultivimit të Tokës (CLRP/PPRT), i cili, mes tjerash, synon të identifikojë kontaminimet dhe të sigurojë kufizimin e rreziqeve të afërta dhe sanimin eventual të tyre.

Burimet kryesore potenciale të identifikuara të kontaminimit të dheut dhe ujërave nëntokësore janë:

- Derdhjet e substancave vajore dhe materieve tjera kimike, veçanërisht në lokacionet e stabilimenteve të mëhershme të gazifikimit, dhe azotikut;
- Shirat acidike, aerosolet dhe grimcat e suspenduara nga termocentralet, aktivitetet e mihjeve, si dhe deponitë e hirit (më parë ka pasur edhe depozitime të ndotësve nga impiantet e vjetra të gazifikimit dhe azotikut);
- Deponimi i mëparshëm dhe aktual i mbeturinave në deponi të hirit, në veçanti në deponinë e hirit të “Kosovës A” dhe në minierën e vjetër (deponia sanitare rajonale) dhe;
- Shkarkimet e ujërave industriale dhe të zeza të pa trajtuara.

Bazuar në hulumtimet më të reja lidhur me testimin e ujërave nëntokësore dhe ujërave të lira sipërfaqësore në fazën e hulumtimit të lokacionit të PPRT-së ka tregtuar nivele paksa të rritura të BTEX (Benzol, Toluën, Etilbenzol dhe Xylene) dhe PAH (hidrokarbonate aromatike policiklike) në disa mostra. Metalet janë brenda standardeve të ujit të pijshëm (OBSh, BE) përveç arsenit, i cili është gjetur në përqendrimet (12 dhe 13 mikro-gramë/L) pak mbi standardet e ujit të pijshëm (10 mikro-gramë/L) në mostrat e marra në përfundim të deponisë së hirit të “TC A”. Këto përqendrimet të arsenit mund të jenë të lidhura me praninë natyrore të këtij elementi në gjeologjinë e zonës. Përfundimi është se rezultatet e testimit nuk mund të identifikojnë asnjë kontaminim të rrjedhësive të ujërave nëntokësore në deponinë e hirit. Ka raportime verbale të kontaminimeve të ujërave nëntokësore në puse, që tani duket se me gjasë lidhet me hedhjen e materieve kimike në galeritë e vjetra të minierës, por një gjë e tillë ka nevojë për hulumtime shtesë. Disa puse të cekëta treguan nivele të larta të përçueshmërisë elektrike (nga kripërat) që sugjerojnë ndikim nga pluhuri i hirit apo derdhjet e ujit nga deponia e hirit<sup>2</sup>.

Hulumtimet nga PPRT<sup>3</sup> treguan praninë e pikave të nxehta me nivel të lartë të mbetjeve fenolike, ujërave fenolike dhe praninë e katranit në deponinë e hirit të “TC A”, ndonëse deponia nuk është përdorur në baza të rregullta për deponimin e këtyre materieve. Shuma totale e këtyre mbetjeve është shumë e kufizuar dhe duket se ato janë të izoluara në masë të pranueshme. Hiri i depozituar në deponitë e hirit përmban nivele të ngritura të metaleve të rënda, por për shkak të përbërjes kimike të hirit potenciali për kullim është i kufizuar. Nivelet e ngritura të disa metaleve të rënda, po ashtu, janë gjetur në deponitë e djerrinës, por të njëjtat ishin të ngjashme me ato të gjetura në natyrë në atë zonë. Në zonën në afërsi të Prishtinës (Arbëri) përreth deponisë së djerrinës, si dhe deponisë së hirit afër “TC A”, janë gjetur shumë deponi ilegale të mbeturinave me mbeturina komunale, mbeturina ndërtimore, mbeturina tjera nga termocentralet, shiritat të vjetër gome, hekurishte etj.

Analiza gjeokimike përfshinte analizën e mostrave të tokës të marra në thellësi të ndryshme (nga 0.50 deri 80 metra) në 11 shpime të reja për përcaktimin e vlerës pH, kalciumit, magnezit, kaliumit, sodiumit dhe metaleve. Në përfundim të deponisë së hirit, afro 2 km nga fshati Dardhishtë, është përdorur një pus i mëhershëm i ventilimit për deponimin e mbetjeve të katranit dhe fenolit. Kjo praktikë e njëjtë ka ndodhur edhe në miniera tjera të mëparshme nëntokësore. Veç kësaj, deponitë e hapura nuk kanë veshje adekuate apo pajisje tjera për mbrojtjen e tokës dhe nuk ka asnjë masë për zvogëlim të ndikimit për të shmangur kontaminimet e derdhjeve të ujërave nga reshjet e vrullshme, dhe stuhitë.

<sup>2</sup> Raporti i Vleresimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) (fq. 18).

<sup>3</sup> Në korrik të vitit 2007 ka filluar “Hulumtimi i lokacionit, organizimi teknik, planifikimi dhe përcaktimi i ndikimit mjedisor” si pjesë e Projektit për pastrimin dhe rikultivimin tokës” (CLRP/PPRT), i cili synon të identifikojë nivelin e kontaminimit dhe të përmirësojë gjendjen mjedisore në rrethinë të minierave dhe termocentraleve të KEK-ut, përmes zvogëlimit të emetimeve të partikulareve (grimcave) nga deponimet e hirit ekzistuese të “Kosovës A”.

### 3.4 Zhurma

Burimet për krijimin e zhurmës janë:

- Zhurma që krijohet nga aktivitetet minerare dhe transporti i thëngjillit, pajisjet për eskavim dhe transport dhe shiritat bartës;
- Rruga që qon në miniera, kryesisht shkaktohet nga kamionët për miniera dhe ata që bartin mbeturina, por edhe nga transporti i punëtorëve;
- Shiritat transportues të linjtit;
- Zhurma operative e “TC A”, si termocentral;
- Zhurma në termocentral vjen nga shiritat bartës, pajisjet thërrmuese, ndezësit, turbinat, gjeneratorët, ventilatorët, kompresorët, pompat, kullat ftohëse dhe oxhaqet;
- Operimi i lokomotivave të KEK-ut;
- Bartja e hirit me shirit prej “TC A” në palosjen e hirit;
- Vet procesi i palosjes së hirit dhe;
- Dy llojet e fundit të burimeve të zhurmës janë pasojë e drejtpërdrejt e punëve aktuale të palosjes së hirit dhe mund të modifikohen ose largohen me aplikimin e koncepteve alternative të deponimit të hirit.

#### 3.4.1 Komentet mbi të dhënat ekzistuese dhe sugjerimet

Siç është shpjeguar në paragrafin e epërm të dhënat janë të pakta dhe zhurma mjedisore duhet konsideruar si problem që ka ndikim në mjedis që shkakton shqetësime serioze për shëndetin dhe mirëqenien (ngacmime dhe pengesa në gjumë) e banorëve.

Indikacionet e pakta në dispozicion tregojnë mundësi të madhe të tejkalimit të standardeve të imisionit të zhurmës (BE, BB) në zonat e banimit përreth kufirit të mihjeve nga një herë edhe në zonat banesore afër “Kosovës B”.

Do duhej ndërmarrë monitorimi i zhurmës në mjedis për të përcaktuar masat e duhura për zbutjen e gjendjes.

Masat reduktuese të zhurmës duhet siguruar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së popullatës në afërsi.

Megjithatë, kushtet meteorologjike, kryesisht drejtimi dhe shpejtësia e erës, absorbimi sipërfaqësor dhe atmosferik, dhe lagështia e ajrit mund të ndikojnë në nivelin dhe shpërndarjen e zhurmës; një fushatë monitorimi është e domosdoshme për të vlerësuar indikatorin “Emetimet e zhurmës” për lokacionet e centraleve dhe mihjeve.

### 3.5 Peizazhi

Peizazhi në territorin e Komunës, gjer me tani, nuk ka ndonjë peizazh që është shpallur i mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi.

Peizazhi natyror në një pjesë të territorit të Komunës në masë të madhe është i ndikuar nga minierat, deponitë e djerrinave, termocentralet dhe deponitë e hirit të “TC-A dhe TC-B”, kështu që kemi një pamje të ashpër të peizazhit natyror. Në pjesët tjera të territorit të Komunës kemi një pamje të mirë të peizazhit natyror.

Në planet e ardhshme, zona e mihjeve ekzistuese, deponizat e hirit dhe deponitimet e djerrinës

do të pastrohen, ri-kultivohen dhe mbillen, rrjedhë që vazhdimisht do të përmirësohet pamja vizuale e peizazhi natyror.

### 3.5.1 Biodiversiteti dhe trashëgimia natyrore

Në territorin e Komunës ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore siç janë:

- Burim i ujit mineral në Graboc të Epërm;
- Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë (Palaj);
- Trung druri i vetëm bliri (*Tilia spec.*), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc) dhe;
- Grup trunjesh druri të bungut (3x *Quercus spec.*, 1x *Quercus cerris*), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc).



Figura 5. Pamje e një peizazhi natyror

Në territorin e Komunës nuk ekzistojnë zona natyrore të mbrojtura me ligj, por ekziston një zonë e veçantë e mbrojtur me ligj siç janë, Monumenti Memorial i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve. Në këtë zonë janë të ndaluara këto aktivitete:

- Ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi i mineraleve dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve transite nëpër zonat rurale dhe;
- Ndërtimet apo zhvillimet që qojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.





Figura 6. Zona e mbrojtur e Gazimestanit

### 3.5.2. Flora dhe Fauna

Në afërsi të fshatrave mund të gjendet vegetacion i vrazhdë. Biotopet natyrore gjenden afër lumit “Sitnica” dhe përfshijnë livadhet e lagështa, komunitetin e llojeve të bimëve barishtore, dhe llojet e drurit të ahut, lisit, shkurret etj., që gjinden në perëndim.

Ndër shpendët e egër të malit e të fushës që ndeshen më shumë janë shqiponja e malit, petriti, grizhlat, sorrat, harabeli, kulumria, bufi, lakuriqi i natës etj. Ndër kafshët e egra që gjenden veçojmë dhelprën, lepurin, ujkun, derri i egër, buklën, iriqin, breshkën etj.

Në ujërat e lumenjve e të kanaleve veçojmë rosat, patat, lejlekun, gjarpërinjtë e ujit, bretkosat, breshkat e ujit etj.

Nga dëmtimi i pyjeve po dëmtohen gjithashtu si flora ashtu edhe fauna e egër. Disa prej tyre janë në zhdukje e sipër si lepuri i egër, fëllënza e malit, shepka e malit, sidomos nga gjuetia e pakontrolluar, si në sezonin e gjuetisë ashtu edhe jashtë sezonit.



Figura 7. Pamje tipike e një lloji të fëllenzave në territorin e Komunës së Obiliqit

## 4. PLANIFIKIMI I HAPËSIRËS NË TERRITORIN E KOMUNËS

### 4.1 Planifikimi urban

Obiliqi është një qendër ekskluzivisht industriale dhe ka rreth 5640 banorë. Dendësia e banorëve për një kilometër katror është 487 b/km<sup>2</sup> (mbi mesataren e Kosovës).

Qyteti i Obiliqit është relativisht vendbanim i ri i karakterit urban, i cili është rritur shpejt pas vitit 2000 kur filloj të shndërrohet në një qendër politiko-administrative dhe kulturore.

Pjesa më e madhe e ndërtimeve janë ndërtime të ulëta deri në dy kate, ndërsa zona me ndërtime relativisht të larta shtrihet përreth rrugës kryesore të qytetit, duke formuar bërthamën urbane të qytetit. Maksimumi i lartësisë në ndërtimet e reja arrin në 6 kate. Ndryshimet e mëdha sociale të ndodhura në Komunë në periudhën e fundit, e gjetën të papërgatitur qytetin nga ana urbanistike, gjë që solli rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit.

Një nga arsyet kryesore ka qenë lëvizja e lirë e njerëzve, e cila solli si pasojë dyndjen e njerëzve nëpër qytete, të cilët, për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, kryen ndërtime të jashtëligjshme pa kriteret urbanistike, duke krijuar kështu zona joformale. Në këto zona bëhet i vështirë disiplinimi i ndërtimeve dhe krijohen vështirësi të mëdha në lidhje me infrastrukturën inxhinierike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefon etj.). Kështu, nga një zhvillim i planifikuar dhe i mbajtur gjithmonë nën kontroll, ky zhvillim urban filloi të dalë nga kontrolli në përmasa të pallogaritshme. Ndërtimet pa kriteret të përcaktuara urbane që një numër i konsiderueshëm nuk kanë leje, po rëndojnë, e dëmtojnë infrastrukturën dhe po zbeh mundësitë urbane të zhvillimit të qytetit në të ardhmen.

Në mungesë të planeve rregullative nuk janë ruajtur hapësirat mjedisore dhe lidhjet funksionale të shtrirjes së strukturave të objekteve me destinime të veçanta siç janë zonat për arsim dhe edukim, shëndetësi, zonat e banimit, zonat e objekteve të sektorit publik, zonat rekreative-sportive, zonat e gjelbërimit publik, zonat për shërbime tregtare, zona hoteliere-turistike etj.

Shumica e problemeve në menaxhimin dhe planifikimin e hapësirës territoriale manifestohet për shkak të:

- Mungesës së planeve rregullative;
- Mungesa e standardeve urbane të avancuara;
- Menaxhim i dobët i hapësirës territoriale në Komunë dhe;
- Ndërtimet pa leje dhe zhvillimi i pakontrolluar i qytetit.

### 4.2 Gjelbërimi publik

Hapësirat e gjelbëruara paraqesin pjesët e pandara të të gjitha strukturave funksionale të zonave të vendbanimeve, si dhe korridoret ekologjike që i lidhin këto hapësira. Hapësirat e gjelbëruara sigurojnë funksion të shumëfishtë të krijimit të një ekuilibri optimal të parandalimit dhe zvogëlimit të ndikimeve urbane negative në mjedis.

Hapësirat në qytet janë të pakta dhe nuk janë të rregulluara. Parqet publike janë të rëndësishme për peizazhin e qytetit dhe kanë një ndikim të konsiderueshëm për qytetar, duke krijuar mundësi për rekreacion dhe çlodhje. Shtimi i hapësirave të gjelbra përfshin rikonstrukcionin dhe ndërtimin e sipërfaqeve të gjelbra ekzistuese apo të reja, gjelbërimi i rrugëve kryesore dhe dytësore me drurë dhe shkurre dekorative, krijimi i hapësirave të gjelbra në blloqet e banimit, sheshet publike, rikualifikimi i hapësirave publike në parqe urbane apo krijimi i të rejave etj., sipas standardeve cilësore bashkëkohore do të funksionon si një filtër në bazë të procesit natyror të fotosintezë për përmirësimin e kualitetit të ajrit.

Sipërfaqet e gjelbëruara ndahen në dy kategori: sipërfaqet e gjelbëruara publike dhe sipërfaqet e gjelbëruar me karakter special.

Sipërfaqet e gjelbëruara publike janë:

- Parqet;
- Gjelbërimi përgjatë rrugëve;
- Gjelbërimi përreth objekteve publike;
- Sipërfaqet e gjelbëruara në mes të blloqeve të objekteve;
- Sipërfaqet e gjelbëruara rreth monumenteve-përmendoreve;
- Sipërfaqet mbrojtura të gjelbëruar-brezat gjelbërues, etj.;
- Sipërfaqet e gjelbëruar me karakter special, përfshihen këto hapësira:
- Kopshtet zoologjike;
- Sipërfaqet e gjelbëruar në hapësirat e spitaleve dhe objekteve shëndetësore;
- Sipërfaqet e gjelbëruara në hapësirat e objekteve shkollore;
- Sipërfaqet e gjelbëruara të terreneve rekreative-sportive;
- Lokacionet e varrezave dhe;
- Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave.

Në territorin e Komunës bie në sy një numër i vogël dhe një radhitje joadekuatë e parqeve. Qyteti nuk posedon park që mund ta karakterizohet si një park qendror, ekzistojnë disa parqe me sipërfaqe të vogla dhe nuk përmbushin nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

## 5. INFRASTRUKTURA

### 5.1 Rrjeti rrugor

Rrjeti rrugor në Komunë ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale.

- Rruga magjistrale M2 Prishtinë-Mitrovicë dhe rrugët rajonale:
- Obiliq-F. Kosovë;
- Obiliq-Milloshëvë-Besjanë;
- Obiliq-Palaj-Sibovc-Shipitullë-Grabovc-Drenas dhe rrugëve lokale (kryesisht të paasfaltuara).

Tabela 10. Janë paraqitur rrugët, relacionet dhe gjatësia e tyre

Kategoritë e rrugëve	Relacioni	Gjatësia në km.
Magjistrale	Shkabaj-Mazgit-Milloshëv-Babimost	9
Rajonale	Obiliq-Milloshëv-Raskov	8
	Obiliq-Dardhisht	6
	Obiliq-Palaj-Lajthisht-Shipitull-Grabovc	14
	Total	28
Lokale	Obiliq (qyteza)	25
	Obiliq-Mazgit	4
	Obiliq-Plemetin	4
	Breznic-Kozaric	10
	Milloshëv-Raskov-Bakshi	5
	Llazarev-Subotiq	2.5
	Mazgit-Mazgit	3
	Lajthisht-Hamidi	3
	Lajthisht-Sibovc	5
	Total	61.5
Rrugët lokale të rendit të 4, të paasfaltuara	Brenda vendbanimeve	40



## 5.2 Hekurudhat

Dy linja hekurudhore kalojnë përmes territorit të Komunës.

Njëra është linja Shkup-Fushë Kosovë-Mitrovicë me stacione në Dardhishtë, Obiliq dhe Plemetin, dhe e dyta është linja Fushë-Kosovë -Pejë, me stacion hekurudhor në Graboc.

Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” janë të lidhura me rrjetë hekurudhor.




Figura 8. Pamje e linjave hekurudhore

## 6. SHËRBIMET PUBLIKE

### 6.1 Furnizimi me ujë cilësorë të pijes

Në Komunën e Obiliqit ekzistojnë dy (2) sisteme për furnizim me ujë cilësorë të pijes:

Sistemi i Batllavës që menaxhohet nga KUR “Prishtina” e që furnizon 70 % të zonës urbane të Obiliqit dhe tetë (8) vendbanime tjera rurale me ujë, një (1) sistem tjetër (puset në “Obiliq i Vjetër”) që menaxhohen nga KUR “Prishtina” që furnizon 30 % të zonës urbane të Obiliqit dhe pesë (5) vendbanime tjera rurale, dhe disa vendbanime nga burimet nëntokësore nga bunarët individual, të cilat nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes dhe nuk janë në përputhje me AI 2/99 MSHMS.

Furnizimi me ujë nga këto dy sistemet është e cilësisë së mirë në këto vendbanime. Sasia e furnizuar, përkundër kufizimeve, është në nivel të kënaqshëm. Reduktimet më të shpeshta bëhen gjatë stinës së verës. Njëri prej shqetësimeve është rrjeti i ujësjellësit në qytet, për shkak të vjetërsisë, dhe ekziston mundësia permanente që uji të kontaminohet.

Vendbanimet e mëposhtme që furnizohen nga Ujësjellësi publik rajonal i Prishtinës janë: Obiliqi, Obiliqi i Vjetër, Mazgiti i ultë, Mazgiti i epërmi, Dardhishta, Palaj, Hade, Lajthishta, Plemetini, Millosheva, Raskova, Bakshia, Llazareva dhe Shkabaj.

Kualiteti i ujit të furnizuar për konsumator nga KRU “Prishtina” në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009, ka qenë më i mirë, me vetëm 0.8 %, të mostrave të analizuar të cilat nuk kanë qenë në përputhje me standardet e përcaktuar nga IKSHPK. Furnizimi me ujë të pijes nga burimet nëntokësore nga bunarët.

Furnizimi me ujë nga bunarët individuale përdoret në katër (4) vendbanime, apo 20 % e vendbanimeve të Komunës. Furnizimi me ujë nga bunarët individual, nuk i plotësojnë standardet e ujit të pijes dhe nuk janë në përputhje me AI 2/99 MSHMS.

Në Komunën e Obiliqit Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka kryer disa matje të cilësisë së ujit të pijshëm nga pusët në zonat rurale, në bazë të rregullores për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Në veçanti, dy mostra të ujit të pijshëm janë marrë në secilin prej fshatrave të përmendur në vijim: Shipitullë, Hade, Bakshi, Milloshevë, Hamidi, Lajthishtë, Sibovc, Bajmovc, Breznicë dhe Kozaricë.

Janë analizuar 20 mostra bakteriologjike, si dhe 20 mostra kimike. Mostrimi është kryer në katër periudha të ndryshme gjatë vitit 2002-2006, shkurt, korrik, nëntor dhe dhjetor. Mostrat janë marrë në dy pika frekuentuese të secilit fshat. Shtëpia e Shëndetit dhe shkolla (ku nuk kanë ekzistuar, mostrat merreshin nga puse individuale të banorëve të fshatit).

Rezultatet vazhdimisht tregojnë se ekziston një nivel i lartë i kontaminimi si në vijim:

- 95 % e mostrave dëshmojnë kontaminim me origjinë fekale apo në formë totale koli-forme, gjë që nuk u përmbahen treguesve të OBSH-së;
- 55 % e mostrave kanë vlera të mëdha të nitriteve dhe nitrateve, gjë që nuk përputhet me treguesit e OBSH-së;

## 6.2. MENAXHIMI I UJËRAVE TË ZEZA-SANITARE

### 6.2.1 Rrjeti ekzistues i kanalizimit të ujërave të zeza-sanitare

Infrastruktura e rrjetit të kanalizimit të ujërave të ndotura, e cila përfshin tubacionet kryesore, d.m.th. primare, sekondare, pusetat etj., është e projektuar dhe ndërtuar gjatë viteve 1970, 1985, 1990, 2000 - 2011, e cila ka përfshirë fillimisht pjesën urbane të qytetit. Rrjeti i kanalizimit përveç grumbullimi të ujërave të ndotura urbane grumbullon edhe ujërat atmosferike. Shkarkimi i ujërave të ndotura bëhet në tetë (8) pika shkarkuese pa trajtim paraprak në lumin “Sitnicë”.

Derdhja e ujërave të zeza-sanitare nëpër sipërfaqe të hapura në ato vendbanime që nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit dhe shkarkimi i ujërave të zeza-sanitare të pa trajtuara në lumenjtë “Llap”, “Drenicë” dhe “Sitnicë”, janë probleme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Andaj, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza-sanitare, është çështje që kërkon zgjidhje të shpejtë.

Mbulimi i vendbanimeve me rrjet të kanalizimit dhe % e kyçeve të ekonomive familjare në territorin e Komunës janë të pasqyruara në tabelën në vijim.

Emri i vendbanimit	Popullsia	Numri i amvisërive	A ka Kanalizim Po /Jo publik	Numri i amvisërive të kyçur	% e popullatë së kyçur në kanalizimin publik	Nëse jo, si shkarkohen ujërat e zeza	Vendshkarkimi i ujërave të zeza
Obiliq	5648	1050	Po	950	100 %		Sitnicë
Obiliqi i vjetër	1160	232	po	190	95 %		Sitnicë
Mazgit i ultë	1441	250	po	270	95 %		Sitnicë
Mazgiti i lartë	1445	250	po	270	95 %		Sitnicë
Llazareva	429	71	po	68	905		Llap
Milloseva	2920	323	po	420	95 %		Llap
Bakshi	602	114	po	100	95 %		Llap
Raskovë	640	100	po	100	95 %		Llap
Bajmofc	1680	210	po	280	95 %		Sitnicë
Breznicë	1292	190	jo	260	95 %		Sitnicë
Kozaricë	469	68	jo	290	95 %		Sitnicë
Plemetin	2588	320	po	190	95 %		Sitnicë
Hamidi	147	27	jo				
Sibofci	963	166	po			Sipërfaqe të hapura	
Grabocfi i Epërm	340	57	jo			Sipërfaqe të hapura	
Shipitullë	295	48	po				
Hade	534	179	jo			Sipërfaqe të hapura	
Lajthishtë	715	130	po			Sipërfaqe të hapura	
Palaj	1463	180	po	300	95 %		Llap
Dardhishtë	1580	198	po			Sipërfaqe të hapura	
<b>Totali</b>	<b>25629</b>	<b>4163</b>		<b>3725</b>	<b>72.3</b>		

## 6.3 MENAXHIMI I SHËRBIMIT ME MBETURINA TË NGURTA KOMUNALE

Përshkrimi aktual i sistemit të organizuar të menaxhimit të mbeturinave të ngurta komunale, pajisjeve dhe mekanizmi teknik në këtë sektor na shërben për të pasur një pasqyrë të përgjithshme të proceseve që lidhen me llojet e mbeturinave dhe të krijimit të një baze për identifikimin, dhe përcaktimin e aspekteve në të cilat nevojitet të bëhen ndryshime. Përshkrimi i bazuar në informata nga kompania, si dhe nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit të të gjithë sistemit të shërbimeve që përfshin operimin, pajisjet, impiantet, kostot dhe cilësinë e shërbimeve që ofrohen. Të gjitha shërbimet që lidhen me mbeturinat e ngurta komunale menaxhohen si shërbime publike në nivel rajonal nga dy kompani:

Kompania rajonale për mbeturina “Pastrimi” në Prishtinë, e cila e menaxhon shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi. Këtë shërbim në nivel lokal e kryen njësisia operative e KRM që vepron në Komunë.

Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës KMDK e cila e menaxhon Deponin rajonale të Prishtinës në Mirash në të cilën deponohen mbeturinat e ngurta komunale që grumbullohen dhe transportohen nga rajoni i Prishtinës.

### 6.3.1 Organizimi i shërbimit për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave

Organizimi i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale është i bazuar në këto skema:

- **Hedhja e mbeturinave në pikat e grumbullimit (PGM)**

Banorët, bizneset dhe institucionet i hedhin (dorëzojnë) mbeturinat e ngurta komunale si të pandara (pa selektuara) në pikën më të afërt të grumbullimit. Pikat e grumbullimit të mbeturinave janë pajisje adekuate, kontejnerë me vëllim 1.1m<sup>3</sup>, shporta prej 120 l ose pajisje jo adekuate siç janë kosha nga llamarinë (bure) prej vitit 2001 të vendosura në sipërfaqe të vogla publike, si dhe mënyra e grumbullimit e quajtur “derë me derë” nëpërmes të qeseve të plastikës. Numri i kontejnerëve që disponon kompania në territorin e Komunës është rreth 240, që nuk i mbulon të gjitha pikat për grumbullimin e mbeturinave, gjendja e kontejnerëve nuk është e mirë, janë të vjetruar dhe pjesërisht të shkatërruar. Në pikat e grumbullimit ku janë të vendosur pajisjet për grumbullimin e mbeturinave, shpesh herë ka hedhje të mbeturinave jashtë pajisjeve, si dhe mbushje të tepërta të kontejnerëve për shkak të dinamikës jo të mjaftueshme për zbrazjen e tyre.

- **Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave deri në deponi**

Mënyra e shërbimit të organizuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është i organizuar në formën e bazuar të zonave të banimit brenda Komunës. Shpeshimi i grumbullimit, numri dhe lloji i kontejnerëve është i definuar për tre sektorë të banimit:

1. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit kolektiv dhe qendra e qytetit bëhet për çdo ditë;
2. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit individual brenda qytetit bëhet një herë në javë dhe;
3. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i vendbanimeve në kuadër të komunës bëhet një herë në javë.

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës, kompania në disponim i ka dy kamionë special, sasia ditore e mbeturinave komunale të grumbulluara dhe transporti i tyre në deponi është rreth 15.500 kg. ose 341.000 kg. për një muaj.

Në sistemin e organizuar të ofrimit të këtij shërbimi janë të përfshira nëntë (9) vendbanime ose 1085 ekonomi familjare, nëse shprehet në përqindje i bie 45 % e vendbanimeve, ose 20 % e ekonomive familjare. Në vijim po i paraqesim informacionet për vendbanimet e mbuluara me shërbim të organizuar, % e ekonomive familjare të mbuluara me këtë shërbim, dinamikën dhe sasinë e mbeturinave që deponohen në deponi.

Në njëmbëdhjetë (11) vendbanime tjera ku nuk funksionon shërbimi i organizuar i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave, hedhja e mbeturinave bëhet nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, për gjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale dhe si pasojë e këtij veprimi vjen deri të krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin.

### 6.3.2 Riciklimi i mbeturinave

Është proces ku krijohen efekte teknike, ekologjike, si dhe ekonomike. Rëndësia qëndron në zvogëlimin drastik të sasisë së mbeturinave komunale të cilat dërgohen në deponi. Me këtë zgjatet jeta e deponive dhe minimizohet rreziku për shëndetin dhe mjedisin, gjithashtu zvogëlohet shfrytëzimi i resurseve natyrore, kursehet në kohë dhe energji.

Sipas analizave të përbërjes së mbeturinave komunale është konstatuar se 35 % janë Mbeturina Organike. Nga kjo rekomandojmë kompostimin dhe fermentimin e mbeturinave organike, si procese shumë të lehta dhe që sjellin përfitime të shumëfishta. Kompostimi i duhur nuk ka ndikim negativ mbi mjedisin, për më tepër ia rikthen natyrës materialin organik mjaft të vlefshëm, i cili në rast të kundërt, do të mbetej në vendgrumbullimin e mbeturinave. Cilësia e kompostit varet nga mënyra e ndarjes së mbeturinave. Nëse mbeturinat organike janë hedhur në të njëjtin kosh së bashku me mbeturinat e tjera, ato bëhen të papërdorshme. Riciklimi dhe kompostimi janë mënyrat kryesore të rruajtjes së vlerës së materialeve të përdorura. Që ky opsion të jetë i realizueshëm, duhet të adresohen dy çështje themelore: së pari materialet duhet jenë në gjendje të rikuperohen në një formë që mund të përdoret. Së dyti duhet të ketë kërkesë për produktin.

### 6.3.3 Ndikimet negative të mbeturinave në mjedis

Pikat për grumbullimin e mbeturinave paraqesin rrezik për përhapjen e sëmundjeve infektive. Në shumë raste kontejnerët janë të dëmtuar dhe në kushte jo të mirë higjieno-sanitare, dhe asnjëherë nuk bëhet dezinfektimi dhe larja e PGM.

Kontejnerët janë shpesh objekt pune për njerëz të rritur dhe në disa raste edhe fëmijë, si kërkuesi joformal të mbeturinave të riciklueshme të cilat, përveç faktit që rrezikojnë shëndetin e tyre nga infeksionet dhe sëmundjet e ndryshme, janë edhe shkaktarë të ndotjes së hapësirave rreth kontejnerëve.

Prania e qenve endacak pranë pikave të kontejnerëve është gjithashtu problem dhe rrezik për përhapjen e sëmundjeve të ndryshme.

Ekzistenca e deponive ilegale vazhdon të mbetet një problem shqetësues mjedisor për banorët që banojnë për rreth këtyre deponive.

Gjendja e amortizuar e makinave për transportin e mbeturinave është problem shqetësua për mjedisin publik.



### 6.3.4 Deponija rajonale e Prishtinës në Mirash

Deponija rajonale e Prishtinës gjendet në Mirash në minierën sipërfaqsite të shterur të linjtit, e cila është e dizajnuar dhe ndërtoar si deponi sanitare e tipit rajonal që me shërbimet e deponimit të mbeturinave i mbulon këto Komuna: Prishtinën, Lipjanin, Obiliqin, Drenasin dhe Fushë-Kosovën, ka një sipërfaqe prej 50 ha me kohë zgjatje për 15 vite, kapaciteti total i deponisë është 3.5 milionë m<sup>2</sup>, ndërsa kapaciteti mujor 6000 t. Deponoja e posedon edhe llagunën për ujëra të zeza në kapacitet prej 4000m<sup>3</sup>.

Deponin rajonale të Prishtinës në Mirash e menaxhon Kompania për Menaxhimin e Deponove të Kosovës e regjistruar si kompani aksionare me emrin Kompania për Menaxhimin e Deponove në Kosovë - Sh. A. – Prishtinë.

Në përgjithësi deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK sa i përket gjendjes së tyre nuk kanë ndryshime të mëdha ndërmjet vete dhe pa përjashtim janë në gjendje të keqe, si pasoje e mos menaxhimit të duhur të tyre, e sidomos në gjendje të vështir është deponia në Mirash. Arsyeja kryesore, por jo e vetmja, është se KMDK nuk ka mundur të i arkëtoj në tërësi borxhet nga KRM, të cilat kanë pjesëmarrje të madhe në biznesin e KMDK.

Ndërmarrja ka pesë (5) punëtorë në deponi, që punojnë me një buldozer totalisht të amortizuar.

Mbetjet transportohen nëpërmjet një rruge të vogël të deponisë, shkarkohen aty dhe shpërndahen me buldozer. Shumë pjesë të deponisë nuk janë të disponueshme, si rezultat i përmbytjes. Punëtorët thjesht i mbulojnë këto zona duke hedhur mbetje të tjera mbi to. Nuk ekzistojnë pajisjet bazë dhe makineritë, siç është për shembull kompaktori (ngjeshësi).

Performanca mjedisore e deponisë është katastrofike për shkak të çdo aspekti të emetimeve potenciale. Mjedisori rrethues i deponisë vuan nga ndotja e mbetjeve, liqeta që rrjedh nga deponia në ujërat nëntokësorë, emetimet e pakontrolluara të biogazrave, e gjithashtu vetë ndezjet janë bërë dukur e shpeshtë në deponi në kohë të thatë të verës, duke shkarkuar përqendrime të larta të gazra të ndryshme që shkaktajnë dioksina dhe furane të llojllojshme.

### 6.3.5 Problemet e evidentuar në menaxhimin e mbeturinave

Problemet në aspektin legjislativ dhe organizativ lokal

- Mungesë të rregulloreve lokale dhe kapacitete të pamjaftueshme administrative;
- Mungesa e planit lokal për menaxhimin e MNK;
- Mbikëqyrja dhe zbatimi i ligjeve në këtë sektor;
- Niveli i ultë i përfshirjes të vendbanimeve në sistem të organizuar të shërbimeve (vetëm 45 %) në grumbullimin dhe transportimin në deponi të MNK;
- Mungesa e pajisjeve, kontejnerëve, shportave dhe kushte të dobëta të pajisjeve që përdoren për grumbullimin e mbeturinave;
- Mos definimi i lokacioneve për vendosje të kontejnerëve, mungon plani për caktimin e pikave (VGM) për vendosjen e kontejnerëve në qytet;
- Sektori komercial nuk posedon kontejner të posaçëm për hedhje të mbeturinave, por ato i hedhin në kontejner të përbashkët me banorë dhe;
- Orari i zbrazjes së kontejnerëve, si dhe transportit të mbeturinave nuk është në përputhje me kërkesat.

#### Krijimi i deponive ilegale

- Në disa pjesë të qytetit, si dhe vendbanime rurale të cilat nuk janë të mbuluara me shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe të transportit të mbeturinave deri në deponon rajonale, mbeturinat hedhen nëpër lëndina, hapësira të pashfrytëzuara, për gjatë brigjeve të lumenjve, rrugëve lokale dhe rajonale, si pasojë e këtij veprimi vjen deri te krijimi i deponive ilegale me efekte negative për mjedisin.

#### Gjendja e rëndë mjedisore në deponin rajonale të Prishtinës

##### Infrastruktura rrugore në deponi:

- Rruga në hyrje e deri të objektet pranuese, si dhe rrugët brenda trupit të deponisë nuk janë të rregulluara, kështu që nuk ka kushte të mira për pranimin e automjeteve që bartin mbeturina, si dhe automjeteve për rastet emergjente (p.sh. zjarrfikësit).

##### Stafi dhe mekanizmi i nevojshëm për operim në deponi:

- Nuk ka staf dhe mekanizëm të nevojshëm për kryerjen e punëve operative në deponi;
- Nuk bëhet rregullisht shpërndarja, shtresimi, mbulimi me materiale inerte më shtresa 15-20cm dhe ngjeshja (kompaktimi) i mbeturinave që të arrihet dendësia 1.1 deri në 1.2 t /m .;
- Nuk bëhet integrimi ditor i materialeve inerte e cila ndikon në mos stabilitet të trupit të deponisë, si dhe ndërtimi integral i rrugëve brenda në deponi;
- Ekziston rreziku potencial për shpërthim të zjarreve brenda deponim;
- Mund të ndodhin lëvizje të mëvonshme të trupit të deponisë;
- Krijohen kushte për ndikimet sekondarë siç janë: shpezët, kundërmimi, pluhuri, insektet, rreziku nga infeksionet, prodhimin e gazrave nga zbërthimi i mbeturinave;
- Mosfunksionimi i sistemit të pompave cirkulare për trajtimin e ujërave të zeza (liqetës) në trupin e deponisë;
- Është rritur niveli i ujërave të zeza në lagunë dhe kanë depërtuar në trupin e deponisë, me këtë sasi të lartë të ujërave (përmytje) nuk mund të bëhet kompaktimi i mbeturinave e as intervenimi në rast emergjente (mjetet e rënda teknike nuk mund të operojnë mbi këtë hapësirë);
- Mungesa e mbikëqyrjes dhe monitorimit të vazhdueshme dhe;
- Kontrollimin e ndotjes dhe njoftimin.



## 7. HULUMTIMI I OPINIONIT PUBLIK NË KOMUNËN E OBILIQIT PËR GJENDJEN MJEDISORE DHE PROBLEMET MJEDISORE ME PRIORITET

Me qëllim të një pasqyrimi të plot të gjendjes mjedisore, problemeve me prioritet dhe mundësitë e zhvillimit ekonomik në hapësirat e territorit të Komunës, Qendra Rajonale për Mjedis (REC) dhe Komuna në kuadër të hartimit të PLVM kanë realizuar një anketë për të hulumtuar opinionin e qytetarëve në tërë territorin e Komunës. Për realizimin e anketës REC-u, në mbështetje të Agjencionit Suedez për zhvillim Ndërkombëtar - Sida ka angazhuar OJQ- Qendra për edukim dhe zhvillim të mjedisit.

### 7.1 Metodologjia e hulumtimit

Anketa gjithëpërfshirëse është zhvilluar përmes të një Pyetësores, i cili ka qenë i përpiluar në katër grupe themelore të pyetjeve.

- Të dhëna bazike për qytetarin e intervistuar;
- Në grupin e parë të pyetjeve për statusin social të qytetarit të anketuar hyjnë këto të dhëna: Moshë, gjinia, arsimimi dhe statusi (nxënës, student, i punësuar, i papunë, amvisë, pensionist);
- Gjendja e tanishme në Mjedis;
- Zhvillimi ekonomik në të ardhmen;
- Vizioni zhvillimor Pyetësoresin e kanë plotësuar personat e trajnuar të OJQ-së “Qendra për edukim dhe zhvillim të mjedisit”, kurse përpunimin e rezultateve të opinionit publik i ka bërë eksperti profesional i angazhuar në kuadër REC-ut, zyra në Prishtinë.


### 7.2 Rezultatet e anketës

Në vijim do të pasqyrohen disa nga rezultatet e anketës:


Tabela 12. Të dhënat bazike dhe shpërndarja e mostrës

Komuna	Gjinia	Meshkuj (51 %)					Femra (49 %)				
	Moshë # i resp.	>18 10%	18-25 20 %	25-50 43 %	50-65 20 %	65 + 7 %	>1 8 10 %	18-25 20 %	25- 50 43 %	50-65 20 %	65+ 7 %
Obiliq	500	26	51	110	51	17	25	49	106	49	16
Obiliq (ALB-90 %)	450	23	46	99	46	15	22	44	96	44	15
Obiliq (MIN-10 %)	50	3	5	11	5	2	2	5	11	5	2


Gjendja e tanishme në mjedis




Ndotësitë kryesorë të mjedisit në territorin e Komunës




Pesë problemet kryesore në mjedis



Zhvillimi ekonomik në të ardhmen



Vizioni zhvillimor





## Pjesa 4

### III. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE MJEDISORE ME PRIORITET

Çështjet mjedisore sipas mendimit të grupit punues të PLVM të harmonizuara me rezultatet e hulumtimit të opinionit publik për gjendjen mjedisore të Komunës së Obiliqit dhe zhvillimet me prioritet janë:

1. Ndotja e ajrit;
2. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore;
3. Toka dhe degradimi i tokës;
4. Menaxhimi i mbeturinave komunale;
5. Zhurma;
6. Furnizimi me ujë të pijes dhe trajtimi i ujërave të zeza-sanitare;
7. Planifikimi urban, gjelbërimi publik dhe zonat rekreativo-sportive dhe;
8. Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit.



## Pjesa 5

## IV. VLERËSIMI I PROBLEMEVE PRIORITARE

Vlerësimi i problemeve prioritare është bërë sipas kësaj metode:

Problemi	Shkaku (Listë shkaqesh që sjellin problemin, që mund të jenë fizike dhe njerëzor).	Shkalla e ndikimit  E lartë E mesme dhe e Ultë	Popullsia që preket  (Numri i banorëve ose përqindja e popullsisë së prekur).	Ndikimi  (Paraqet ndikimin negative në: Mjedis, Shëndet, Mirëqenie).	Prioritarizimi  (I matur me shkallën: * = Pak i rëndësishëm ** = Mesatarisht i rëndësishëm *** = Shumë i rëndësishëm (kërkon zgjidhje të menjëhershme).



Çështjet mjedisore: 1. Ndotja e ajrit

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioriteti
1. Niveli i lartë e përqendrimit të emetimeve të pluhurit pluhur fluturues, thërrmija të pluhurit, bloza, SO <sub>2</sub> dhe NO <sub>x</sub> ; nga termocentralet ekzistuese dhe aktivitetet minerare.	1. Prodhimi i energjisë elektrike nga termocentralet me një performancë të dobët mjedisore; 2. Mungesa e impiantit për reduktimin e SO <sub>2</sub> (De-sulfurues) dhe NO <sub>x</sub> (De-Nox-ues) në TC-A dhe në TC-B; 3. Deponitë e pambuluara të hirit, palosja e hirit nga TC-A gjatë deponimit aktiv të hirit, mungesa e vegjetacionit; 4. Vetëndezja e qymyrit në mihjet sipërfaqësore të qymyrit; 5. Aktivitetet minerare në mihjet sipërfaqësore të qymyrit.	E lartë  Zona e territorit në ndikim të këtyre emetimeve. 80 % e territorit të Komunës.	I tërë komuniteti.	Cilësia ajrit e dobët me pasojë në shëndetin e popullatës siç janë: kërcënim serioz në shëndetin e popullatës.	***
2. Lirimi i gazrave serrë dhe tymi nga deponija rajonale e Prishtinës në Mirash.	1. Zbërthimi organik i mbeturinave në deponi. Tymi nga zjarret në deponi mund të jetë i rrezikshëm si rezultat i dioksinave dhe përmbajtjes së ndotësve të tjerë.	E lartë 70 % e territorit të Komunës.	14800 banorë.	Cilësia e ajrit e dobët me pasojë në shëndetin e popullatës siç janë:	***
3. Ndotja e ajrit nga trafiku në komunikacion dhe sistemet ngrohëse nga amvisnit, objektet publike etj.	Mungesa e një sistemi bashkëkohor për ngrohjen e banesave.	E mesme	I tërë komuniteti.	Cilësia ajrit e dobët me pasojë në shëndetin e popullatës, siç janë:	***
4. Cilësia e rrugëve të kategorisë së katërt.	Rrugët lokale të kategorisë së katërt (të pa asfaltuara) nëpër vendbanime.	E mesme 100 % e territorit të Komunës.	I tërë komuniteti.	Cilësia ajrit e dobët me pasojë në shëndetin e popullatës, siç janë:	**
5. Monitorimi i cilësisë së ajrit.	Mungon sistemi për monitorim sipas kërkesave dhe standardeve të BE-së.	E lartë	I tërë komuniteti.	Të dhënat mbi cilësinë e ajrit në territorin e Komunës janë të kufizuara dhe jo-sistematike.	***

Çështjet mjedisore: 2. Mbrojtja dhe përmirësimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioriteti
1. Shkarkimi i ujërave të ndotura teknologjike nga TC-A dhe TC-B.	1. Nuk bëhet trajtimi i ujërave të ndotura teknologjike në TC- A dhe TC- B; 2. Nuk bëhet trajtimi paraprak i ujërave të ndotura nga minierat për të zvogëluar ngarkesën e materieve të ngurta.	E lartë	50 % e komunitetit.	Ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke ndikuar negativisht në shëndetin publik të komunitetit. E dëmton ekosistemin e lumit “Sitnicë” dhe “Drenicë”.	***
2. Sedimentet e metaleve të rënda nga ujërat e ndotura nga minierat e linjtit.	Nuk bëhet trajtimi paraprak i ujërave të ndotura nga minierat për të zvogëluar ngarkesën e materieve të ngurta.	E lartë	50 % e komunitetit.	Ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke ndikuar negativisht në shëndetin publik të komunitetit. E dëmton ekosistemin e lumit “Sitnicë” dhe “Drenicë”.	***
3. Ujërat e ndotura nga deponitë e hirit TC-A dhe TC-B.		E lartë	50 % e komunitetit.	Ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke ndikuar negativisht në shëndetin publik të komunitetit. E dëmton ekosistemin e lumit “Sitnicë” dhe “Drenicë”.	***

Çështjet mjedisore: 3. Toka dhe degradimi i tokës

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioriteti
1. Ndotja e tokës nga depozitimi i ndotësve të ajrit.	Depozitimi i ndotësve të ajrit në tokë (dhe) nga termocentralet dhe nga deponitë e hirit në TC-A dhe TC-B.	Në një zonë me rreze prej 10 km.	Vendbanime të cilat janë në zonën e ndikuar të ndotjes.	Rreziqet e mundshme për shëndetin njerëzor që dalin nga ekspozimi direkt i ndotjes.	***
2. Degradimi i tokës nga eksploatimi i linjtit.	1. Mungesës së rivegjetimit në Deponitë e hirit TC-A, TC-B. 2. Mungesa e rehabilitimit dhe rikultivimit të minierave të shfrytëzuar.	Sipërfaqe të tokës, rreth 1500 ha.	50 % popullsia e vendbanimeve afër këtyre zonave.	Ndikim negativ në pamjen (estetikën) e peizazhit natyror.	***

Çështjet mjedisore: 4. Menaxhimi i mbeturinave komunale

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioriteti
1. Kapacitete të pamjaftueshme institucionale dhe administrative në zbatimin e ligjit.	1.1 Mungesa e rregullores komunale për administrimin e mbeturinave kom.; 1.2 Mungesa e planit lokal për menaxhimin e MNK; 1.3 Mbikëqyrja, kontrolli dhe zbatimi i ligjeve në këtë sektor dhe zbatimi i gjobave;	E lartë I tërë territorin e Komunës.	I tërë territorin e Komunës, me rreth 26000 banorë .	Ofrimi i shërbimeve joefikas në menaxhimin e mbeturinave dhe ndotje të mjedisit.	* * *
2. Niveli i ultë i përfshirjes së ekonomive familjare (20 %) në sisteme të organizuar të shërbimeve në grumbullimin dhe transportin në deponi të MNK.	2.1 Mungesë e pajisjeve, kontejnerëve, shportave dhe kushte të këqija të pajisjeve që përdoren për grumbullimin e mbeturinave; 2.2 Mospërkufizimi i lokacioneve për vendosje të kontejnerëve - Mungon plani për caktimin e pikave (VGM) për vendosjen e kontejnerëve në qytet; 2.3 Sektori komercial nuk posedon kontejner të posaçëm për hedhje të mbeturinave, por ato i hedhin në kontejner të përbashkët me banorë. 2.4 Orari i zbrazjes së kontejnerëve, si dhe transportit të mbeturinave nuk është në përputhje me kërkesat; 2.5 Mungesa e makinave vetëshkarkues dhe amortizimi i tyre.	E lartë I tërë territorin e Komunës.	I tërë territorin e Komunës, me rreth 26000 banorë .	Ndotje e mjedisit Rrezik i sëmundjeve infektive Zënie e hapësirave publike dhe krijimi i deponive ilegale. Ndikim negativ në estetikën e peizazhit natyrorë. Ndikim negativ në standardin jetësor dhe mirëqenien e qytetarëve.	* * *
3. Krijimi i deponive ilegale.	Në disa pjesë të qytetit si dhe në vendbanime rurale të cilat nuk janë të mbuluara me shërbimin e organizuar të grumbullimit dhe të transportit të mbeturinave deri në deponin rajonale.	E lartë I tërë territorin e Komunës.	I tërë territorin e Komunës, me 12000 banorë .	Grumbullimi i mbetjeve në vend të hapur, shpërndarje në rrugë. Ndotja e ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe mundësia për përhapje të sëmundjeve infektive. Rrugë të ndotura. Ulë imazhin e komunitetit dhe ndikon negativisht në standardin dhe mirëqenien e komunitetit.	* * *

4. Gjendja e rënd mjedisore në deponin rajonale të Prishtinës.	1. Mungesa e infrastrukturës rrugore në deponi; 2. Mungesë e stafit dhe mekanizmit të nevojshëm për kryerjen e operimeve ditorë në deponi, shtresimi, mbulimi dhe kompaktimi i mbet; 3. Mos trajtimi i ujërave të ndotura në deponi; 4. Mungesa e sistemit ventilues për lirim të gazrave nga deponoja.	E lartë	50 % e territorit të Komunës, me 12000 banorë .	Ndotje e mjedisit, ajrit, ujit dhe tokës. Mundësi për përhapjen e sëmundjeve infektive. Krijohen kushte për influencë sekondare, siç janë, shpezët, qenët endacak, kundërmimi, pluhuri, insektet, shpërthimet e zjarrit.	* * *
5. Mungon sistemi i përpunimit dhe riciklimi i mbeturinave komunale.	1. Mungesa e fondeve dhe interesimi jo i mjaftueshëm i sektorit privat.	E mesme	I tërë komuniteti.	Rritet volumi i mbeturinave që duhet deponuar.	**
5. Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik për mbeturinat dhe ndarjen e tyre.	1. Niveli jo i mjaftueshëm i vetëdijes të komunitetit mbi sistemin e organizuar të menaxhimit të mbeturinave; 2. Edukimi mjedisor është i pamjaftueshëm për shumë arsye: mungesa e materialeve të shkruara, mungesa e aktiviteteve të përbashkëta.	E lartë	I tërë territor i i Komunës, me rreth 26000 banorë .	Asgjësimi jo i duhur i mbeturinave nga qytetarët krijon erëra, dhe rrezik për shëndetin rreth zonës së kontejnerëve dhe pikave të grumbullimit të mbeturinave. Përfshirje e ulët në sistemin e organizuar për trajtimin e mbeturinave.	* * *

Çështjet mjedisore: 5. Furnizimi me ujë cilësorë të pijes dhe trajtimi i ujërave të zeza-sanitare

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioritet i
Mungesë e kapaciteteve për furnizim me ujë cilësor të pijes në qytet dhe në disa fshatra.	Mungesë kapacitetesh. -Rrjet i amortizuar. Ndërrhyrjet në rrjet në mënyrë ilegale.	E lartë	Popullsia e qytetit. -Lokalet e shërbimit. -Njësitë tregtare.	Ulë cilësinë e jetesës. Mungon higjiena dhe pastërtia. Rrit shpenzimet e konsumatorëve. Ndikimi në koston jetësore.	* * *
Furnizim me ujë jo cilësor nga puset individuale.	Disa fshatra ende nuk kanë sistem të ujësjellësit.	E lartë	Dy fshatra të Komunës	Mungesa e ujit të pijshëm të kontrolluar çon në rritjen e të sëmurëve me sëmundje infektive.	***
Mungesa e sistemit të rrjetit të kanalizimit në vendbanimet Breznicë, Kozaricë, Grabovc i Ep. Dhe në vendbanime joformale.	Mjetet financiare Mungesë e fondeve për studime dhe ndërtime të këtyre rrjeteve.	E mesme	2.500 banorë.	Rrit rrezikun e ndotjes së mjedisit. Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave që përdoren për t'u pirë. Rrit rrezikun e ndotjes së ujërave nëntokësore.	***
Sistemi i rrjetit të kanalizimeve është shumë i amortizuar dhe nuk është në gjendje të përballojë tendencat e reja të zhvillimit të qytetit.	Dëmtimi i kanaleve për shkak të ndërhyrjeve në të. Amortizimi i sistemit për shkak të moshës së tij. Shtimi i ndërtesave dhe i popullsisë.	E mesme	50 % e qytetit.	Rrezik epidemish nga dalja në sipërfaqe e ujërave të përdorura. Aromat që dalin nga pusetat janë helmuese për kalimtarët.	* * *
Mungesa e një impianti të përpunimit të ujërave të zeza që shkarkohen në lumenjtë "Sitnicë", "Llap" dhe "Drenicë".	Mungesë investimesh. Mungesë e fondeve për studime dhe investimin. Mungesë bashkëpunimi ndërinstitucional.	E lartë	- Gjithë Komuna dhe popullsia vendase.	Rritë nivelin e ndotjes së lumenjve. Shkakton ndotje të peizazhit dhe të burimeve natyrore.	* * *

Çështjet mjedisore: 6. Planifikimi urban dhe gjelbërimi publik dhe zonat rekreativo-sportive

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioritet i
1, Zhvillimi urban i pakontrolluar dhe ndërtime pa leje.	Mungesa e Planit rregullative- urbane.  Mungesa e një studimi urbanistik.	E lartë	Popullsia vendase, 11020 banorë.	Pengon mundësinë e zhvillimit të prioriteteve. Zënia e tokës dhe mjediseve publike. Ulë cilësinë e mjedisit. Rritë volumin e inerteve. Ndotja e ajrit.	***
2. Mungesa e hapësirave për parkingje në qytet.	Mungesa e investimeve.	Zona urbane e qytetit E mesme	Popullsia urbane.	Krijimi i pengesave në trafikun urban.	**
3. Mungesa e hapësirave të gjelbëruara. Mungesa e një parku qendror në qytet.	Mungesa e Planit rregullative-pjesore për rregullimin e gjelbërimit publik.	E lartë	Popullsia urbane.	Mungesa e një mushkërie të qytetit, që do të ndihmonte në mbajtjen pastër të ajrit.	***
4. Mungesa e hapësirave rekreative dhe sporte të ndryshme në natyre.	Mungesa e fondeve për këtë destinim.	E mesme	I tërë komuniteti.	Nuk ka kushte rekreative dhe sportive për qytetarët e të gjitha grup-moshave. Mungesë të kushteve për një mjedis çlodhës dhe argëtues për qytetarët.	**

Çështjet mjedisore: 7. Mbrojtja nga zhurma

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioritet i
1. Mungesë e një studimi-analize për ndikimi e zhurmës tek receptorët e mundshëm.	1. Mungesa e fondeve për këtë destinim.	E mesme	65 % i popullsisë.	Në shëndetin publik të qytetarëve.	**
Mbrojtja nga emitimet e nivelit të zhurmës dhe vibrimit.	Mungojnë barrierat fizike për pengimin e zhurmës përreth minierave dhe TC-ve.	E mesme	65 % i popullsisë.	Ndikim negative në shëndetin e qytetarëve.	**

Çështjet mjedisore: 8. Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit

Problemi	Shkaku	Shkalla e ndikimit	Popullsia që preket	Pasojat	Prioritet i
Mungon strategjia për zhvillimin e bujqësisë në territorin e Komunës	Ka mungesë të kapaciteteve profesionale.	E lartë	I tërë komuniteti.	Zhvillim i pakontrolluar në sektorin e bujqësisë.	***
Humbja dhe degradimi tokës bujqësore.	Ndërtimet në tokat bujqësore me bonitet të lartë. Zgjerimi i mihjeve sipërfaqësore të linjtit.	E lartë	60 % e popullsisë.	Humbje tokës bujqësore me bonitet të lartë.	***
Njohuri të pamjaftueshme të fermerëve për përdorimin e plehrave dhe pesticideve adekuate.	Mungesa e trajnimeve të nevojshme për përdorimin e drejtë të plehrave dhe pesticideve.	E mesme	I tërë komuniteti.	Ndotja e mjedisit-tokës bujqësore.	***
3. Prerja, djegia e pyjeve dhe mos zëvendësimi i tyre.	Prerja pa kriteret. Mosfunksionimi i shtetit për të mbrojtur pyjet. Mungesë financimi dhe organizimi për të përmirësuar pyjet.	E lartë	I gjithë komuniteti.	Ndikon negativisht në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve, ulë burimet financiare.	***
Zhvillimi i turizmit në territorin e Komunës.	Mungesë e planit rregullues, i cili përcakton në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kriteret mjedisore vendet e zhvillimit të turizmit.	E mesme	I gjithë komuniteti.	Në zhvillim të qëndrueshëm në Komunë të turizmit ekologjik, i cili rrit tërheqjen në zonë - vizitorëve.	**



## Pjesa 6

### V. VIZIONI, MUNDËSITË DHE SYNIMET

#### VIZIONI

“Komuna e Obiliqit, qendër industriale për prodhimin e energjisë së pastër nga Linjiti, me një Mjedis të planifikuar dhe të menaxhuar sipas kërkesave dhe standardeve të BE-së, që siguron rritje ekonomike, mirëqenie sociale dhe gjendje të kënaqshme mjedisore”.

Mundësitë përmes të cilave do të arrihet vizioni i deklaruar:

- Prodhimin e energjisë së pastër nga Linjiti, që siguron përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe tokës, në pajtueshmëri të plot me kërkesat dhe standardet e BE-së;
- Mbrojtjen e shëndetit të banorëve, florës dhe faunës dhe peizazhit natyror;
- Fuqizimin dhe forcimin e kapaciteteve për monitorim të gjendjes mjedisore;
- Menaxhimin e hapësirës urbane dhe gjelbërimi publik;
- Planifikimi dhe menaxhimi efikas i shërbimeve publike;
- Krijimi i kushteve për mbrojtjen e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit, dhe
- Edukimin mjedisor dhe informimin e komunitetit etj.

Ky vizion ka për synim:

- Përmirësimi gradual i gjendjes së përbërësve mjedisore (ajri, uji, toka dhe biodiversiteti) në territorin e Komunës së Obiliqit;
- Vendosjen e një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit të parametrave mjedisor;
- Përmirësimi i planifikimit urban dhe gjelbërimit publik;
- Përmirësimi i performancës në ofrimin e shërbimeve publike dhe;
- Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjeve dhe zhvillimi i turizmit etj.



## Pjesa 6

### VI. PLANI I VEPRIMIT

#### Çështjet mjedisore: 1 Ndotja e ajrit<sup>1</sup>

Problemi	Veprimet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja (€)	Efekti
1. Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit pluhur fluturues, thërrmija të pluhurit, bloza, SO <sub>2</sub> dhe NO <sub>x</sub> , nga termocentralet ekzistuese dhe aktivitetet minerare.	1. Përmirësimi i performancës mjedisore të TC “Kosova A” dhe mundësia e operimit të saj deri në fillimin e procesit të mbylljes me 31.12.2017; 2. Rrafshimi, stabilizimi i shpatit jug-perëndim të deponisë dhe rikultivimi i sipërfaqeve të deponisë; 3. Transporti hidraulik i hirit të freskët nga TC-A në mihjen e Mirashit; 4. Të aktivizohet sistemi për spërkatje gjatë aktiviteteve minerare; 5. Hartimi i planit operativ për evitimin dhe parandalimin e zjarreve në Miniera; 6. Pyllëzimi i brezave gjelbërues: Rreth minierave ekzistuese dhe të reja të mihjes, deponive të hirit dhe TC-ve ekzistuese.	2012 - 2015	Qeveria; KEK-u dhe; Komuna.	Kosto e llogaritur në strategjinë për mbrojtje të ajrit, si dhe në Planet e veprimit të KEK-ut.	-Përmirësimi gradual i cilësisë së ajrit në pajtueshmëri me direktivat e BE-së. -Ulje të numrit të rasteve me sëmundje të rrugëve të sipërme respiratorë. -Ulje të niveleve të PM <sub>10</sub> brenda normave të OBSH. -Ulje të sëmundjeve të syve, të rrugëve të sipërme respiratorë. -Parandalimi i përkeqësimit të shëndetit publik të qytetarëve. -Përmirësimi i cilësisë së ajrit, pamje e estetike e peizazhit natyror. -Përmirësimi i cilësisë së ajrit, duke ndikuar si një filtër natyror në zvogëlimin e shkallës së përqendrimit të emetimeve në ajër, e sidomos të pluhurit dhe emetimi i gazrave serrë (p.sh. CO <sub>2</sub> , CH <sub>4</sub> , NO <sub>x</sub> etj).
2. Lirimi i gazrave serrë dhe tymi nga deponija rajonale e Prishtinës në Mirash.	1. Vendosja e sistemit-rrjet për të mbledhur biogazrat të cilat lirohen nga zbërthimi i mbeturinave; 2. Të hartohet plani për shfrytëzimin e energjisë nga biogazrat.	2013 - 2014	Qeveria dhe KMDK.	450.000 25.000	Përmirësohet situata mjedisore, minimizohet ndotja e ajrit nga shpërbërja e mbetjeve organike në ajër dhe djegia e tyre. Krijimi i vendeve të punës dhe Rritje e mirëqenies sociale.

<sup>1</sup>Plani i veprimit është në harmoni të objektivave të KEK-ut dhe Qeverisë së Kosovës.

Plani Lokal për Veprim në Mjedis 2012-2017, për Komunën e Obiliqit

3. Ndotja e ajrit nga sistemet ngrohëse nga amvisnit dhe objektet publike.	1. Hartimi i planit-projektit për shfrytëzimin për ngrohje qendrore i ujit/avullit të procesuar nga TC-B; 2. Shpërndarja, furnizimi dhe kyçja e Komunës së Obiliqit në rrjetin me ngrohje qendrore nga termocentrali; 3. Zbatimi i kyçjes së konsumatorëve në rrjetin komunal të ngrohjes qendrore në Obiliq.	2014 - 2016	Komuna.	42.000 380.000	Përmirësimi i cilësisë së ajrit, duke ndikuar si një filtër natyror në zvogëlimin e shkallës së përqendrimit të emetimeve në ajër, e sidomos të pluhurit dhe emetimi i gazrave serrë (p.sh.: CO <sub>2</sub> , CH <sub>4</sub> , NO <sub>x</sub> etj.)
4. Lirimi i pluhurit nga rrugët ekzistuese të paasfaltuara (me gurë dhe zhavorr) në qytet dhe fshatra.	1. Mirëmbajtja e rrugëve në qytet (pastrimi, fshirja dhe larja e tyre); 2. Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatra.	2014 - 2016	Komuna.	15.00 380.000	Përmirësimi i cilësisë së ajrit. Krijimi i një mjedisi me një peizazh të bukur natyror.
5. Monitorimi dhe kontrolli i kufizuar dhe jo-sistematik i cilësisë së ajrit.	1. Hartimi i planit dhe kriterëve për monitorimin e ajrit sipas standardeve të BE-së; 2. Pajisjet dhe vendosja e sistemit për monitorimin e ajrit në tri lokacione-tri pika monitoruese; 3. Krijimi i sistemit për të dhënat mbi kualitetin ajrit; 4. Ngritja e kapaciteteve institucionale për monitorim dhe menaxhim të sistemit për informim mbi të dhënat për cilësinë e ajrit.	2013 - 2014	Komuna.	30.000 360.000	Analiza e rezultateve do të bëhet në bazë të modelit të shpërndarjes së ndotjes sipas vendndodhjes së receptorëve. Ndërtimi i bazës së të dhënave mbi monitorimin e kualitetit të ajrit.

Plani i Veprimit detal për disa projekte për sektorin e ajrit për Komunën e Obiliqit  
Aktivitete Administrative dhe Inspektive (A)

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
A1	Obiliq	Edukimi dhe vetëdijesimi i publikut për rrezikun nga djegia e mbeturinave dhe materialeve tjera në vende të hapura.	Numri i njerëzve të trajnuar.
A2	Obiliq	Promovimi i shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (biogas, panelet solare, energjia e erës, hidro-energji) për sistemin e ngrohjes së ujit në amvisëri dhe shërbime publike.	Popullata e informuar për shfrytëzimin e energjisë.
A3	Obiliq	Edukimi dhe vetëdijesimi i publikut për shfrytëzimin e transportit publik dhe biçikletave.	Popullata e informuar për shfrytëzimin e energjisë.

Aktivite Teknike dhe Teknologjike (T)

Aktiviteti	Lokacioni	Përshkrimi	Kriteri/Indikatorët e suksesit
T1	Obiliq	Shfrytëzimi i energjisë për ngrohje nga procesi i co-gjenerimit në "Kosovën B" dhe zgjerimi i rrjetit.	Përgatitja e studimit të fisibilitetit në këto komuna për shfrytëzimin e ngrohjes nga gjenerimi i KEK-ut.
T2	Obiliq	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të transportit publik.	Numri i rritur i shfrytëzuesve të transportit publik.

Regjioni	Prishtinë
Aktiviteti	A1
Emri i aktivitetit	Edukimi dhe vetëdijesimi i publikut për rrezikun nga djegia e mbeturinave dhe materialeve tjera në vende të hapura.
Lokacioni	Obiliq.
Objektivat	Objektive është ngritja vetëdijes se publikut për rrezikun nga djegia e mbeturinave dhe materialeve tjera në vende të hapura.
Komentet	Disa gazra që lirohen nga djegia janë kancerogjene si p.sh.: Dioksina nga djegia e gomave.

Fazat e punës		Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1	Përgatitja e ToR-it për nevojat e trajnimit.	Komuna dhe MMPH.	10 000
2	Përgatitja e projekt dokumenteve për tenderim.	Komuna.	2 000
3	Implementuesi i projektit.	Implementuesi dhe Komuna.	25000
		Total	37000

Faza e punës	Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
1			X	X									
2				X	X	X							
3						X	X	X					
4								X					

Regjioni	Prishtina
Aktiviteti	A2
Emri i aktivitetit	Promovimi i shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme (biogas, panelet solare, energjia e erës, hidro-energjia) për sistemin e ngrohjes së ujit në amvisëri dhe shërbime publike.
Lokacioni	Obiliq.
Objektivat	Ngritja e vetëdijes në shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtrishme.
Komentet	

Fazat e punës		Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1	Përgatitja e ToR-it për nevojat e trajnimit.	Komuna, MMPH dhe MZHE.	10000
2	Përgatitja e projekt dokumenteve për tenderim.	Komuna.	5000
3	Implementuesi i projektit.	Implementuesi dhe Komuna.	42000
		Total	57 000

Faza e punës	Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
1			X										
2				X	X	X							
3						X	X	x					

Regjioni	Prishtina
Aktiviteti	A3
Emri i aktivitetit	Edukimi dhe vetëdijesimi i publikut për shfrytëzimin e transportit publik dhe biçikletave.
Lokacioni	Obiliq.
Objektivat	Objektive është ngritja vetëdijes se publikut për shfrytëzimin e transportit publik dhe biçikletave.
Komentet	

Fazat e punës	Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1 Formimi i grupit punues.	Komuna, MMPH dhe MTT.	1500
2 Involvimi i ekspertëve.	Komuna.	10 000
3 Përgatitja e program për edukim.	Komuna, MMPH dhe MTT.	2000
4 Drafti final dhe aprovimi nga komunat.	Komunat.	10 000
5	Total	26500

Plani dhe koha e implementimit

Faza e punës	Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
1	x	X	X	X									
2					X	X							
3						X	X	X					
4								X	x	x	x	X	X

Regjioni	Prishtina
Aktiviteti	T1
Emri i aktivitetit	Shfrytëzimi i energjisë për ngrohje nga procesi i co-gjenerimit në "Kosovën B" dhe zgjerimi i rrjetit.
Lokacioni	Obiliq.
Objektivat	Objektive kryesore është shfrytëzimi i energjisë për ngrohje nga procesi co-gjenerimit të "Kosovës B".
Komentet	Një sasi energjie që lirohet nga procesi i ftohjes së termocentralit mund të shfrytëzohet për ngrohje qendrore.

Fazat e punës	Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1 Formimi i grupit punues për të bërë një studim fezibiliteti.	Komuna, MMPH dhe kompania rajonale.	2500
2 Involvimi i ekspertëve.	Komuna, donatorët dhe kompania rajonale.	20 000
3 Drafti i parë dhe organizimi i diskutimeve.	Komuna, MMPH dhe donatorët.	12 000
4 Drafti final dhe aprovimi nga komunat.	Kompania e zgjedhur dhe donatorët.	5000
5	Total	39 500

Plani dhe koha e implementimit

Faza e punës	Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
1	x	X	X	X									
2					x	X							
3						X	X						
4								x					

Regjioni	Prishtina
Aktiviteti	T2
Emri i aktivitetit	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të transportit publik.
Lokacioni	Obiliq.
Objektivat	Objektive kryesore është shfrytëzimi sa më i madh i transportit publik, si mjet transporti.
Komentet	Ky është një nder prioritetet e draft-strategjisë së cilësisë së ajrit.

Fazat e punës	Organizata përgjegjëse	Vlera e përafërt (€)
1 Formimi i grupit punues për të përgatitur një pilot-projekt në komuna.	Komuna, MMPH dhe MTT.	1500
2 Involvimi i ekspertëve.	Komuna.	5000
3 Prezantimi i programit. Përmirësimi i transportit publik.	Komuna dhe MTT.	22000
4 Implantimi i projektit.	Komuna dhe MMPH.	200 000
5	Total	228 500

Plani dhe koha e implementimit

Faza e punës	Viti i parë				Viti i dytë				Viti i tretë				Viti i katërt
	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	
1			X	X	X								
2						X	X						
3						X	X	x					
4									x	X	x	X	X



Çështjet mjedisore: 2. Mbrojtja dhe përmirësimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Problemi	Veprimet	Afati kohor	Institucioni përgjegjës	Kostoja (€)	Efekti
1. Shkarkimi i ujërave të ndotura teknologjike nga TC-A dhe TC-B.	1. Ndërtimi i basenit për trajtimin e ujërave të ndotura tekn. në TC A dhe B.	2013-2016	KEK-u dhe Komuna.	Kosto e llogaritur në Planet e veprimit të KEK-ut.	Krijohen mundësi për përpunimin, për të zvogëluar konsumin e ujit të pastër, si dhe riciklimin e ujërave të ndotura teknologjike.
